



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 28

Tiranë – E mërkurë, 24 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 17.2.2016	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme, e cila vepron nëpërmjet Ambasadës Zvicerane në Shqipëri për Projektin “Lëviz Albania”, faza e parë, korrik 2015–qershor 2019.....
	2355
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 113, datë 17.2.2016	Për përcaktimin e ngjyrave dhe shenjave dalluese të mjeteve lëvizëse të Policisë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.....
	2362
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 114, datë 17.2.2016	Për kalimin në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes të Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për degën e Arkivit Shtetëror Vendor në Berat, të katit të parë e të katit të dytë të objektit nr. 1 dhe objektit nr. 2, pjesë të pronës nr. 1047, me emërtim “Qendër mobilizimi”, me vendndodhje në Berat.....
	2364
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 116, datë 17.2.2016	Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit.....
	2366
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 17.2.2016	Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve në njësitë e qeverisjes qendrore, për vitin 2016.....
	2369
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 17.2.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 23, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2016 në njësitë e qeverisjes qendrore”.....
	2370
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 17.2.2016	Për miratimin e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për periudhën 1 janar–15 qershor 2016 dhe 15 shtator–31 dhjetor 2016, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.....
	2371

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 17.2.2016	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore (CMIS).....	2373
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 121, datë 17.2.2016	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të arkivimit dhe menaxhimit të dokumenteve të vjetërsisë në punë dhe të periudhave të sigurimit (DMAIS).....	2374
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 122, datë 17.2.2016	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit, të kalkulimit dhe pagesës së përfitimit (PCAMS).....	2374
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 123, datë 17.2.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar.....	2375
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 17.2.2016	Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil.....	2376
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.2.2016	Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë.....	2379
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 126, datë 17.2.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive që preken nga sheshet e depozitimit/magazinit të tubave dhe kampeve të punëtorëve, stacionet e kompresorëve dhe valvulat e bllokimit (pjesë e projektit TAP).....	2382
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 17.2.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 173, datë 25.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kv Ersekë-Korçë”.....	2393
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 128, datë 17.2.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 301, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 400 kv, Vau i Dejës-Morinë”.....	2398
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 129, datë 17.2.2016	Për shtesë fondesh në buxhetin e bashkive, për vitin 2016, për pastrimin e kanaleve ujëtare dhe kulluese.....	2401
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 130, datë 17.2.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 289, datë 17.5.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)”, të ndryshuar.....	2401
	Aneksi I i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 69, datë 27.1.2016, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 13, datë 5.2.2016.....	2402

**VENDIM****Nr. 112, datë 17.2.2016**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
KONFEDERATËS ZVICERANE, TË
PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA
ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM (SDC) E
DEPARTAMENTIT FEDERAL
ZVICERAN TË PUNËVE TË JASHTME,
E CILA VEPRON NËPËRMJET
AMBASADËS ZVICERANE NË
SHQIPËRI PËR PROJEKTIN “LËVIZ
ALBANIA”, FAZA E PARË, KORRIK 2015
– QERSHOR 2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme, e cila vepron nëpërmjet Ambasadës Zvicerane në Shqipëri për projektin “Lëviz Albania”, faza e parë, korrik 2015 – qershor 2019, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË KONFEDERATËS
ZVICERANE, TË PËRFAQËSUAR NGA
AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM
DHE BASHKËPUNIM (SDC) E
DEPARTAMENTIT FEDERAL ZVICERAN
TË PUNËVE TË JASHTME, E CILA VEPRON
NËPËRMJET AMBASADËS ZVICERANE NË
SHQIPËRI PËR PROJEKTIN “LËVIZ
ALBANIA”**

FAZA E PARË**korrik 2015 – qershor 2019**

Një projekt dypalësh bashkëpunimi dhe zhvillimi

Në përpyetje për të forcuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë midis dy vendeve,

Në vijim të Marrëveshjes Kuadër për Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Ndihmës Humanitare midis Këshillit Federal Zviceran, më 11 maj 2007 dhe e ratifikuar nga Kuvendi Shqiptar me ligjin nr. 9801, datë 13 shtator 2007,

Në respektim të parimeve demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut - siç janë të përcaktuara veçanërisht në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut - që frymëzon politikat e brendshme dhe të jashtme të të dyja Palëve dhe përfaqësojnë një element thelbësor në të njëjtin qëndrim me objektivat e kësaj marrëveshjeje,

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Konfederatës Zvicerane kanë rënë dakord mbi termat dhe kushtet që janë shprehur më poshtë:

Neni 1**Kushtet e përgjithshme dhe përkufizimet**

Kudo që është përdorur në këtë marrëveshje projekt, përveç kur konteksti kërkon ndryshe, termat në vijim do të kenë kuptimet si më poshtë:

a) “Palët Kontraktuese” nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverinë e Konfederatës Zvicerane;

b) “Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë” nënkupton Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Zyra e zëvendëskryeministrit;

c) “Qeveria e Konfederatës Zvicerane” përfaqësohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim



(SDC) dhe Bashkëpunim e Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme;

d) “Projekt” nënkupton projektin “Lëviz Albania”;

e) “SDC” nënkupton Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme;

f) “Grant” nënkupton kontributin financiar të dhënë nga qeveria Zvicerane sipas kësaj marrëveshjeje;

g) “Partneri zbatues” nënkupton konsorciumin e drejtuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA).

Neni 2

Përgjegjësia për zbatim

Autoritetet e mëposhtme do të jenë përgjegjëse për zbatimin e marrëveshjes:

Për Këshillin e Ministrave të Shqipërisë:

Zyra e zëvendëskryeministrit.

Zyra e zëvendëskryeministrit do të jetë bashkëpunëtorja qeveritare e projektit.

Për qeverinë e Konfederatës Zvicerane:

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC),

e përfaqësuar nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri.

SDC-ja do t'i besojë zbatimin e projektit konsorciumit të drejtuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA).

Neni 3

Qëllimet dhe objektivat

Objekti i projektit është: Qytetarët shqiptarë përfitojnë nga përmirësimi i demokracisë vendore.

Rezultatet specifike të këtij projekti janë si më poshtë:

a) (në nivel vendor) Aktorët e shoqërisë civile ndikojnë në përcaktimin e përparësive, në vendimmarrje dhe në mbikëqyrjen e autoriteteve vendore;

b) (në nivel kombëtar) Aktorët e shoqërisë civile ndërmarrin dhe mbështesin ndryshime strukturore për të përmirësuar demokracinë në nivel vendor.

Për të arritur këta objektiva, projekti do të bashkëpunojë me institucionet e mëposhtme:

- Qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, median, njësitë e qeverisjes vendore, ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore, ministrin e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Zyrën e

zëvendëskryeministrit dhe Ministrinë e Financave.

Ndërhyrjet, aktivitetet kryesore dhe rezultatet e parashikuara janë specifikuar në dokumentin e projektit, të datës 16 qershor 2015. Bazuar në këtë dokument, është hartuar një përmbledhje, që përbën pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje. Dokumenti i projektit për fazën e parë mbulon periudhën 1 korrik 2015 – 30 qershor 2019.

Neni 4

Detyrimet dhe Palët Kontraktuese

Detyrimet specifike të Qeverisë së Konfederatës Zvicerane përfshijnë:

a) Deri më 30 qershor 2019, qeveria e Konfederatës Zvicerane synon të parashikojë fonde në formë të një granti të parimbursueshëm në vlerën maksimale prej 6'000'000 CHF (gjashtë milionë franga zvicerane), i cili do të përdoret në mënyrë ekskluzive për zbatimin e projektit sipas qëllimeve dhe objektivave të përcaktuar më sipër në nenin 3;

b) Ky grant nuk mund të alokohet për ndonjë qëllim tjetër. Çdo pjesë e papërdorur e grantit, e cila do të mbetet në fund të projektit është subjekt i rifinancimit të Qeverisë së Konfederatës Zvicerane;

c) Qeveria e Konfederatës Zvicerane nëpërmjet SDC-së ka kontraktuar konsorciumin e drejtuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) si organizatat zbatuese;

d) Granti do të shpërndahet dhe auditohet sipas dispozitave të kontratës ndërmjet SDC-së dhe OSFA-së.

Detyrimet specifike të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfshijnë:

a) Zyra e zëvendëskryeministrit do të veprojë si bashkëpërgjegjëse për orientimin strategjik të projektit;

b) Do të sigurojë lidhjen e “Lëviz Albania” me politikat kombëtare dhe të kornizave ligjore përkatëse për shoqërinë civile, me qëllim mundësimin dhe nxitjen e koherencës së objektivave të “Lëviz Albania” me kushtet e kornizës kombëtare;

c) Mbështetjen e lehtësimit dhe shpërndarjen e përvojës dhe të informacionit bazuar në rezultatet e arritura dhe ndikimet e projektit në nivel kombëtar;

d) Mbështetjen dhe lehtësimin e lidhjes dhe bashkëpunimin me ministrinë dhe institucionet e tjera;



e) Sigurojë reagimin dhe bashkëpunimin e strukturave të decentralizuara në nivel rajonal dhe/ose vendor;

f) Të vërë në dispozicion alokimet e nevojshme buxhetore për të rimbursuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për projektin për një shumë maksimale prej 144'750 CHF (njëqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë franga zvicerane). Rimbursimi i TVSH-së do të kryhet në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi;

g) Këshilli i Ministrave do t'u krijojë mundësinë ekspertëve të huaj, të angazhuar në bazë të kësaj marrëveshjeje dhe anëtarëve të familjeve të tyre që të përjashtohen nga të gjithë taksat gjatë vlefshmërisë së kësaj marrëveshjeje, sipas nenit 4.1, pika "c" të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Teknik dhe Financiar dhe Ndihmës Humanitare.

Neni 5

Menaxhimi i projektit

a) Projekti është një sipërmarrje e përbashkët ndërmjet Zyrës së zëvendëskryeministrit dhe SDC-së nëpërmjet Ambasadës Zvicerane.

b) Qeveria e Konfederatës Zvicerane ka kontraktuar për këtë projekt një konsorcium të drejtuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) si agjencitë zbatuese të projektit, sipas një kontrate të nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe OSFA-së. Kjo agjenci zbatuese merr përsipër në emër të Qeverisë së Konfederatës Zvicerane të gjitha detyrat operationale, administrative dhe mbikëqyrëse të projektit, duke përfshirë rimbursimet, monitorimin dhe raportimin.

c) SDC-ja mund të mandatojë ekspertë vendorë dhe të huaj afatgjatë dhe afatmesëm për të mbështetur zbatimin e projektit.

d) SDC-ja mund të mandatojë individë të tjerë dhe organizata vendorë ose ndërkombëtare për zbatimin e pjesëve të veçanta të projektit, si për shembull, shqyrtimin gjatë gjysmës së projektit dhe për vlerësimin në përfundim të projektit.

e) Zyra e zëvendëskryeministrit ndërmerr veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve të rena dakord të projektit; ofron akses për informacionin përkatës, duke përfshirë të dhëna statistikore, që janë të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të projektit.

Neni 6

Mbikëqyrja dhe koordinimi

Në mënyrë që të garantohet mbikëqyrja, cilësia, qëllimi dhe koordinimi i projektit, si dhe për të trajtuar çështjet e politikave, do të ngrihet një Bord Këshillimor (BK) dhe takimet do të zhvillohen dy herë në vit (zakonisht në janar dhe në shtator). BK-ja do të arrijë kuorumin vetëm kur të jenë të pranishëm përfaqësuesit e të dyja Palëve Kontraktuese. Vendimet merren me konsensus të të gjithë anëtarëve të pranishëm me të drejtë vote. Nëse nuk mund të arrihet konsensus do të fillojë një proces negocimi. SDC-ja rezervon të drejtën për vendimin përfundimtar.

BK-ja do të përbëhet nga institucionet e mëposhtme, me një votë për secilin:

- 1 përfaqësues nga Zyra e zëvendëskryeministrit;
- 1 përfaqësues i Ambasadës Zvicerane;
- 1 ekspert të shquar të demokracisë vendore dhe të shoqërisë civile ose medias.

Në bazë të temës për diskutim do të ftohen si vëzhgues pa të drejtë vote, aktorë të tjerë (përfaqësues nga Ambasada Zvicerane, ministri të linjës, OJF, projekti dhe projekte të ngjashme).

Sekretariati i Bordit Këshillimor ofrohet nga projekti "Lëviz Albania". Menaxheri i projektit merr pjesë në takim pa të drejtë vote.

BK-ja do të ndërmarrë detyrat e mëposhtme:

- Dhënien e këshillave për ekipin e projektit të udhëzimeve dhe të rekomandimeve strategjike, teknike dhe operationale në lidhje me fushat e ndërhyrjes së "Lëviz Albania", qasjet metodologjike dhe instrumentet të projektit.

- Shprehjen e mendimeve për planin vjetor të veprimit të projektit.

- Këshillimin e ekipit të projektit për qëllimet apo objektivat tematikë dhe gjeografikë për përdorimin e instrumenteve të projektit, sipas informacionit të marrë nga raportet monitoruese të ekipit të projektit;

- Rishikimin e dokumenteve strategjike, raporteve vjetore dhe planeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësime të mëtejshme.

Me kërkesë të njërit prej anëtarëve të BK-së, mund të kërkohet të zhvillohet një takim i paprogramuar. Takimet bashkëdrejtohen nga Palët Kontraktuese.



Palët Kontraktuese do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën, deri në nivel të arsyetueshëm të praktikueshëm, do të konsultohen me njëra-tjetrën për çdo ngjarje që ndërhyt ose rrezikon të ndërhyjë në zbatimin e suksesshëm të projektit.

Neni 7

Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve

a) Mallrat dhe shërbimet që do të financohen përmes të ardhurave të kontributit zviceran do të prokurohen në përputhje me rregullat e konsorciumit të drejtuar nga OSFA-ja, të cilat janë bashkërenduar me legjislacionin zviceran për prokurimet publike. Në përputhje me nivelin e vlerës monetare, disa lloje prokurimesh mund të kryhen në nivel vendor.

b) Gjatë kohëzgjatjes së projektit, mallrat e përfutuara nga fondet e SDC-së për përdorim të projektit do të mbeten në dispozicion të pakufizuar të projektit dhe nuk do të devijohen nga projekti pa një miratim paraprak me shkrim nga SDC-ja.

c) Nëse për ndonjë arsye, projekti duhet të ndërpritet, përdorimi i mallrave të ofruara nëpërmjet kontributit zviceran do të vendoset me shkrim nga Palët.

d) Në fund të projektit, SDC-ja duhet të vendosë mbi pronësinë dhe përdorimin e mallrave të prokuruar gjatë periudhës së zbatimit të projektit.

e) Mallrat e prokuruar nga projekti për organizatat partnere do t'i dorëzohen dhe do të merren përsipër nga autoriteti përkatës kompetent me miratimin e SDC-së.

Neni 8

Pezullimi dhe përfundimi i marrëveshjes

a) Secila Palë ka të drejtë të përfundojë këtë marrëveshje nëpërmjet një njoftimi me shkrim gjashtë muaj përpara përfundimit.

b) Nëse njëra nga Palët çmon se kjo marrëveshje nuk mund të arrihet më ose që Pala tjetër nuk po përmbush detyrimet e saj, Pala tjetër do të ketë të drejtën të pezullojë ose të përfundojë këtë marrëveshje, duke i dhënë një njoftim me shkrim tre muaj para. Pavarësisht nga sa më sipër, çdo Palë mund ta përfundojë këtë marrëveshje me efekte të menjëhershme në rast të ndonjë shkeljeje të konsiderueshme të marrëveshjes. Shkelje e konsiderueshme nënkupton shkelje të rënda të një prej objektivave të rëndësishëm të kësaj marrëveshjeje.

Faqe | 2358

c) Pezullimi dhe mundësia për të hyrë përsëri në fuqi do t'i njoftohet menjëherë Palës tjetër nëpërmjet mjeteve diplomatike dhe do të hyjë në fuqi 30 ditë pas marrjes së informacionit nga Pala tjetër.

d) Në rast se ngjarjet nga forca madhore (katastrofa natyrore etj.) pengojnë zbatimin e marrëveshjes, secila Palë mund të përfundojë marrëveshjen që hyn në fuqi që nga momenti kur bëhet i pamundur vazhdimi i saj.

e) Në rast të një përfundimi të parakohshëm të kësaj marrëveshjeje ose në fund të projektit, çdo fond i pashpenzuar brenda kuadrit të projektit do t'i kthehet SDC-së.

Neni 9

Modifikimet dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo modifikim ose ndryshim i kësaj marrëveshjeje duhet të bëhet me shkrim, me pëlqimin e të dyja Palëve.

Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen nëpërmjet negociatave diplomatike ndërmjet Palëve.

Neni 10

Dispozitat e përgjithshme

Në kuadrin e kësaj marrëveshjeje, Palët nuk duhet të kërkojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi përfitime të çfarëdolloj natyre. Ato nuk duhet të pranojnë ndonjë kërkesë të tillë. Çdo ofertë, dhuratë, pagesë, shpërblim apo përfitim i çdolloji si një sjellje e paligjshme dhe praktikë korruptuese nënkupton një shkelje të kësaj marrëveshjeje dhe justifikon përfundimin e saj, si dhe/ose marrjen e masave korrigjuese, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 11

Shtojcat

Përmbledhja e dokumentit të projektit (shtojca 1) përbën pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

Neni 12

Kohëzgjatja dhe hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje mbulon periudhën, që përfshin fazën përgatitore dhe fazën kryesore, nga data 1 korrik 2015 deri më 30 qershor 2019. Ajo do të hyjë në fuqi me përfundimin e procedurave të brendshme ligjore dhe do të përfundojë sapo të



dyja Palët të kenë përmbushur detyrimet e tyre kontraktuale përkatëse.

Kjo marrëveshje është hartuar në katër kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe. Të dyja versionet e teksteve janë autentike dhe kanë të njëjtën vlerë. Në rast të ndryshimeve në interpretim, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Palët e mëposhtme konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë marrëveshje të hartuar në Tiranë, më 21 dhjetor 2015.

Për Këshillin e Ministrave
të Republikës së Shqipërisë
Niko Peleshi
Zëvendëskryeministër
Këshilli i Ministrave

Për qeverinë e
Konfederatës Zvicerane
Christoph Graf
Ambasador
Ambasada e Zvicrës në
Shqipëri

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

“Lëviz Albania” është një projekt novator që synon të ketë një efekt katalizator për demokracinë vendore në Shqipëri.

Përkufizimi i “Lëviz Albania” për “demokracinë vendore” është vendimmarrje gjithëpërfshirëse dhe mbikëqyrje e qeverisjes vendore që sjell transparencë dhe përgjegjshmëri më të madhe, si dhe shërbime publike të përmirësuar.

“Lëviz Albania” do ta forcojë demokracinë vendore në të gjithë vendin nëpërmjet kultivimit të një shoqërie civile vendore me bazë komunitare, që ka ndikim dhe nxit kërkesën për qeverisje të mirë. Në të njëjtën kohë do të ndërmerren projekte strategjike dhe veprimtari advokatie në nivel kombëtar, për të mundësuar krijimin e një mjedisi që do të nxisë një demokraci vendore më të mirë dhe të qëndrueshme.

Në përgatitjen e këtij projekti, “Lëviz Albania” ka kryer një punë të madhe kërkimore në terren, duke kryer më shumë se 200 intervista dhe seanca diskutimesh me aktorë të shoqërisë civile në të gjithë vendin. Gjetjet e studimit e kanë pasuruar perceptimin nga ana e ekipit të projektit të faktorëve nxitës dhe frenues të ndryshimeve në nivel kombëtar dhe vendor, si dhe të aftësive, kapaciteteve, interesave dhe potencialeve të tyre.

Qëllimi parësor i “Lëviz Albania” është: Qytetarët shqiptarë përfitojnë nga përmirësimi i demokracisë vendore

Objektivat e “Lëviz Albania”, janë:

- Rezultati 1: (në nivel vendor) Aktorët e shoqërisë civile ndikojnë në përcaktimin e përparësive, vendimmarrje dhe mbikëqyrjen e autoriteteve vendore.

- Rezultati 2: (në nivel kombëtar) Aktorët e shoqërisë civile ndërmarrin dhe mbështesin ndryshime strukturore për të përmirësuar demokracinë në nivel vendor.

“Lëviz Albania” punon duke u bazuar në premisën ose “teoria e ndryshimit” se për të sjellë dhe për të ruajtur një kulturë të qeverisjes gjithëpërfshirëse, transparente dhe të përgjegjshme, është e domosdoshme të mbështetet në mënyrë të vazhdueshme kërkesa e qëndrueshme për një qeverisje më të mirë.

Për ta arritur këtë, ajo ka përgatitur një strategji, e cila do të: 1) Përmirësojë mjedisin kombëtar fuqizues për demokraci vendore; 2) Mobilizojë platformat e aktorëve të demokracisë vendore në mënyra krijuese; 3) Përqendrojë vëmendjen kombëtare tek idetë dhe aktivitetet e saj; 4) Nxisë koalicionet horizontale dhe vertikale të palëve të interesuara për të trajtuar sfidat komplekse; dhe do të 5) Promovojë sinergji strategjike të projekteve që mbështesin kërkesën për qeverisje të vërtetë demokratike dhe projekteve që forcojnë aftësitë e institucioneve publike për ta ofruar atë. Kjo qasje plotëson mbështetjen që ofrohet nga shumë donatorë, duke përfshirë edhe Ambasadën Zvicerane, për forcimin e aftësive të institucioneve publike në nivel vendor, për t’u shërbyer më mirë zgjedhësve të tyre. Për këtë qëllim, “Lëviz Albania” do të përdorë instrumentet e mëposhtme:

1. **Grantet, grantet individuale dhe mbështetjen emergjente** për aktorët e shoqërisë civile (OJF), organizatat me bazë komunitare, median, institucionet akademike, grupet e të rinjve dhe grave dhe për individët (kampionë të demokracisë), të cilët do të jepen pjesërisht nëpërmjet konkurseve të ideve publike me vizibilitet të madh, të organizuar në nivel vendor në gjithë Shqipërinë.

2. **Një instrument mundësues strategjik (IMS)**, i cili është projektuar për të shfrytëzuar pikat e forta të brendshme të “Lëviz Albania”, si: 1) Nxitëse dhe mundësuese e reformës; 2) Ndërtuese e kapaciteteve qytetare vendore; dhe



3) Përkrahëse strategjike e ndryshimeve të mëdha. IMS-ja do të bëjë ndërhyrje të cilat do të nxisin dhe do të mundësojnë një gamë të gjerë aktiviteteve për demokraci në mbarë Shqipërinë dhe do të rrisë mundësitë për sigurimin e qëndrueshmërisë së tyre.

Secili nga instrumentet e projektit përforcon njëri-tjetrin. Për shembull, IMS-ja krijon një mjedis më fuqizues për përfituesit e granteve dhe granteve individuale, duke filluar nga zbatimi i drejtpërdrejtë i projekteve për trajtimin e problemeve strukturore që pengojnë demokracinë vendore (p.sh., zgjedhje jo të drejtpërdrejta të këshilltarëve, financa bashkiake jotransparente etj.). Gjithashtu, ai do të mbështesë drejtpërdrejt përfituesit e granteve dhe të mbështetjes emergjente për rritjen e kapaciteteve dhe asistencë në komunikim, për të shtuar ndikimin e tyre në nivel vendor. Ai do të nxisë krijimin e koalicioneve me bazë komunitare, nëpërmjet metodologjisë së sesioneve të orientimit dhe të zhvillimit të kapaciteteve.

Në të njëjtën kohë, grantet dhe grante individuale do të informojnë shpërndarjen e IMS-së nga ana e “Lëviz Albania”, duke përfshirë edhe fushat me përparësi të ndjekura nga grupet e qytetarëve, si edhe pengesat dhe vështirësitë që ata hasin. Ky informacion më pas do të kanalizohet në aktivitetet dhe punën mbështetëse të IMS-së në nivel kombëtar. Grantet dhe grantet individuale do të nxisin konkretisht edhe krijimin e aleancave dhe koalicioneve të aktorëve qytetarë, përmes hartimit të thirrjeve për ide në konkurse publike. Gjithashtu, thirrjet do të kanalizojnë edhe punën e marrësve të granteve, me qëllim që ata të synojnë si sfida strukturore, ashtu dhe sfidat e orientuara nga kërkesa me të cilat përballet demokracia shqiptare.

Ajo që ka rëndësi është se të gjitha këto instrumente janë hartuar dhe do të përdoren në mënyrë që të sigurojnë: 1) Barazinë gjinore kudo dhe gjatë gjithë kohës; 2) Përdorimin e medias si

nxitëse e ndryshimeve; dhe 3) Angazhimin e aktorëve qeveritarë sa herë që është e nevojshme.

Tabela më poshtë paraqet numrin e parashikuar të përfituesve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga projekti “Lëviz Albania” gjatë kohës së zbatimit të tij:

Të drejtpërdrejtë: marrës granti, Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) dhe individë	100–150 marrës granti nga OSHC-ja 50 individë
Të drejtpërdrejtë: OSHC dhe individë (si përfitues të mbështetjes të IMF-së)	300 aktorë të shoqërisë civile
Të tërthortë: Qeverisjet vendore dhe qytetarët e tyre	50 nga 61 njësi të qeverisjes vendore
Të tërthortë: Ministritë e linjës	Të paktën 4 nga 19 ministritë, p.sh., ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Ministria e Financave, ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Paketat orientuese të financimit për grante, grante individuale dhe mbështetje emergjente për projektin 4-vjeçar të “Lëviz Albania”, janë:


1. Viti I – 505,963 franga zvicerane;
2. Viti II – 1,198,258 franga zvicerane;
3. Viti III – 1,198,258 franga zvicerane;
4. Viti IV – 559,058 franga zvicerane.

Fondi i parashikuar i financimit për aktivitetet e Instrumentit Mundësues Strategjik (projektet e vetiniciuara dhe shërbimet me vlerë të shtuar për partnerët) është: 732.108 franga zvicerane.

Shuma e planifikuar për vlerësimin e jashtëm të projektit është 30.000 franga zvicerane.

“Lëviz Albania” angazhohet që të garantojë standarde cilësore dhe transparente në administrimin dhe shpërndarjen e fondeve në dispozicion. “Lëviz Albania” ka përgatitur një Manual Grantesh që rregullon dhe detajon procesin e dhënies së granteve, duke u bazuar në përvojën e konsorciumit.

Grafiku i mëposhtëm përmbledh qasjen e ndërhyrjes:



Njëkohësisht, “Lëviz Albania” ka parashtruar disa hapa të fuqishëm, që synon të ndërmarrë për të garantuar këndvështrimin gjinor në gjithë projektin, maksimizimin e angazhimit strategjik të medias dhe sigurimin më të mirë të mundshëm, sa herë që nevojitet, të bashkëpunimit me qeverinë. Gjithashtu, ajo do të finalizojë Strategjinë gjithëpërfshirëse të Komunikimit të projektit, për të arritur rastet e suksesshme, për të siguruar pasqyrimin e gjerë në media (dhe në median sociale) të të gjitha ngjarjeve dhe aktiviteteve të saj dhe për të frymëzuar në një shkallë më të gjerë kampionët e demokracisë në mbarë vendin që të luajnë një rol efikas në rritjen e kërkesës së fuqishme për përmirësimin e demokracisë vendore.

Media do të luajë dy role thelbësore në projekt: rolin klasik të marrëdhënieve me publikun dhe rolin e advokacisë. Siç është vënë në dukje, ajo do të përdoret për të siguruar që aktivitetet të transmetohen në mbarë vendin, me qëllim që t’i frymëzojnë sa më shumë aktorët qytetarë për të bërë përpjekje për përmirësimin e demokracisë vendore. Media dhe organizatat e medias shihen, gjithashtu, edhe si përfitues të mundshëm të granteve dhe granteve individuale, si individë ose si aktorë të drejtpërdrejtë, ose si aktorë në kuadër të koalicioneve më të gjera; për

të rritur përfshirjen, transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve publike vendore, përmes gazetarisë investigative, programeve dhe medias së shkruar, të cilët do të kontribuojnë në mjedisin e përgjithshëm mundësues, përmes ndërveprimit me organizatat e shoqërisë civile, për të nxitur debatin publik, diskutimet dhe idetë e tjera që ata mund të paraqitin për të përmirësuar demokracinë vendore.

“Lëviz Albania” ka përfshirë një regjim dinamik monitorimi dhe vlerësimi me pesë drejtime, për të ndjekur përparimin e bërë dhe për të mësuar nga përvojat dhe qasjet e ndjekura. Ky regjim përfshin: 1) Raportimin përshkrues dhe financiar, bashkë me një anketë për të mësuarin dhe zhvillimin; 2) Barometrin e “Lëviz Albania” për të vlerësuar treguesit e demokracisë në mënyrë sasore dhe cilësore para dhe pas çdo projekti, si dhe për vlerësimin e të gjitha projekteve së bashku pas katër vjetësh; 3) Angazhimin e gazetarëve investigues në bashki të synuara, për të mësuar me hollësi rreth asaj që është bërë; 4) Vlerësimin e ndërmjetëm dhe vlerësimin përfundimtar; dhe 5) Raportimin e rregullt para Bordit Këshillimor të projektit.

Strategjia e paraqitur këtu pasqyron shkallën dhe shumëllojshmërinë e përvojës së ofruar nga konsorciumi zbatues - Fondacioni i Shoqërisë së



Hapur për Shqipërinë, Co-PLAN dhe Partners Albania. Konsorciumi bashkon organizatat vendore me përvojë të spikatur, të cilat ndajnë vlerat dhe qasjen metodologjike të Ambasadës Zvicerane. Anëtarët e Konsorciumit janë vetë menaxherë të efektshëm, zhvillues të shoqërisë civile dhe përfaqësues të ndryshimeve. Konsorciumi ofron përvojë të shquar në:

- Grante dhe menaxhim financiar
- Promovimin e barazisë gjinore dhe shoqërisë civile
- Qeverisjen vendore
- Ndërtimin e koalicionëve
- Mbështetjen kombëtare dhe vendore
- Marrëdhëniet me median

Konsorciumi ka caktuar një ekip projekti me shumë përvojë dhe aftësi, të kryesuar nga znj. Valdet Sala. Gjatë fazës përgatitore, ekipi i projektit dhe grupi i ekspertëve kanë bashkëvepruar me njëri-tjetrin, kanë kryer kërkime komplekse dhe të thelluara, kanë organizuar grupe fokusi për të vërtetuar konstatimet e studimit, kanë analizuar/shqyrtuar mjedisin e

mediave dhe së bashku kanë hartuar dokumentin e projektit me një pjesëmarrje të madhe.

Studimi përgatitor konfirmoi se “Lëviz Albania” vjen në kohën e duhur. Ndryshimet politike dhe të politikave të kohëve të fundit, duke përfshirë edhe ligjet e reja për decentralizimin, reforma territoriale dhe administrative, konsultimet publike dhe mundësitë për të marrë informacion, duhet jo vetëm të fuqizojnë njësitë e qeverisjes vendore, por edhe të krijojnë mundësi të reja për përfshirjen e qytetarëve dhe për mbikëqyrjen e punëve publike në nivel vendor. Këtë vit do të mbahen zgjedhjet e rëndësishme vendore, të cilat do të përcaktojnë se kush do t'i kontrollojë nënndarjet e reja administrative. Është e domosdoshme të përfitohet në mënyrë të mençur nga kjo mundësi. Kjo është çka “Lëviz Albania” është e gatshme të bëjë.

Buxheti total në vite

Kodi	Linja e buxhetit	Viti 1 1.7.2015 - 1.7.2016	Viti 2 1.7.2016 - 1.7.2017	Viti 3 1.7.2017 - 1.7.2018	Viti 4 1.7.2018 - 1.7.2019	Fondet totale	Përqindja e totalit
Pjesa 2	Zyra vendore (mbështetëse)	39,573	40,851	40,851	38,116	159,391	2.66%
Pjesa 3a	Ekspertët afatgjatë	265,598	265,598	265,598	265,598	1,062,390	17.71%
Pjesa 3b	Ekspertët afatshkurtër	32,610	31,780	31,780	51,230	147,400	2.46%
Pjesa 3c	Mbështetje vendore	105,091	101,530	101,530	99,022	407,174	6.79%
Pjesa 4	Grante të nxitura nga kërkesa, grante individuale dhe reagim i shpejtë	505,963	1,198,258	1,198,258	559,058	3,461,537	57.69%
	projekt ndërsektorial IMF+ shërbime me vlerë të shtuar IMF për partnerët	135,902	192,902	192,902	210,402	732,108	12.20%
	Rishikimi i jashtëm i projektit			30,000		30,000	0.50%
	Fondet totale të projektit	1,084,736	1,831,204	1,860,634	1,223,426	6,000,000	100%

VENDIM

Nr. 113, datë 17.2.2016

PËR PËRCAKTIMIN E NGJYRAVE DHE SHENJAVE DALLUESE TË MJETEVE LËVIZËSE TË POLICISË USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të ligjit nr. 13/2015, “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Policia Ushtarake në ushtrimin e funksioneve të saj përdor mjetet lëvizëse tokësore operacionale dhe mjete lëvizëse të tjera.

2. Ngjyrat e mjeteve të Policisë Ushtarake janë si më poshtë vijon:

a) Ngjyra e mjeteve operacionale është kamuflazh, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Ngjyra e mjeteve të tjera është e zezë, sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Shenjat dalluese të mjeteve të Policisë Ushtarake janë stema, mbishkrimi, pajisjet sinjalizuese, ndriçuese e zanore, si më poshtë vijon:

a) Stema e Policisë Ushtarake, me specifikimet teknike sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Stema vendoset në mënyrë të dukshme në dy faqet anësore të mjetit.

b) Mbishkrimi “POLICIA USHTARAKE”, me specifikimet teknike sipas aneksit 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë

përbërëse e tij. Mbishkrimi vendoset në mënyrë të dukshme në dy faqet anësore të mjetit.

c) Pajisjet sinjalizuese, ndriçuese e zanore (sirena), me specifikimet teknike sipas aneksit 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Pajisjet sinjalizuese, ndriçuese e zanore, (sirena) vendosen në mënyrë të dukshme në pjesën e sipërme të mjetit.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1

Ngjyra e mjeteve operacionale të Policisë Ushtarake

Ngjyra e mjeteve operacionale që përdor Policia Ushtarake është kamuflazh.



Mjetet e ngjyrosura me ngjyrë kamuflazh do të kenë të njëjtat ngjyra që përdorin mjetet e Forcave të Armatosura të RSH-së me RAL 6014 JESHILE e errët MAT, RAL 8022 e ZEZË, RAL 8017 KAFE.

ANEKSI 2

Ngjyra e mjeteve të tjera të Policisë Ushtarake

Ngjyra e mjeteve të tjera që përdor Policia Ushtarake është e zezë.



Mjetet e ngjyrosura me ngjyrë të zezë me RAL 9005.

ANEKSI 3

SHENJAT DALLUESE - STEMA

Stema e Policisë Ushtarake vendoset në dy anët e mjetit në mesin e dyerve të përparme.



ANEKSI 4

SHENJAT DALLUESE - MBISHKRIMI

Mbishkrimi “POLICIA USHTARAKE” vendoset në dy anët e mjetit dhe shkruhet me ngjyrë të bardhë me shkronja me madhësi, 8 cm lartësi dhe 6.5 cm gjerësi. Mbishkrimi nënvizohet me në vijë të kuqe me trashësi 2 cm.



ANEKSI 5

SHENJAT DALLUESE - SINJALIZUESET

Pajisjet sinjalizuese akustike të llojit kolonë me ngjyrë blu të hapur të tipit kolonë me dy ngjyra.

**VENDIM**

Nr. 114, datë 17.2.2016

**PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË
PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES TË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
ARKIVAVE, PËR DEGËN E ARKIVIT
SHTETËROR VENDOR NË BERAT, TË
KATIT TË PARË E TË KATIT TË DYTË
TË OBJEKTIT NR. 1 DHE OBJEKTIT
NR. 2, PJESE TË PRONËS NR. 1047, ME
EMËRTIM “QENDËR MOBILIZIMI”,
ME VENDNDODHJE NË BERAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar dhe nenit 901 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, për degën e Arkivit Shtetëror Vendor në Berat, të katit të parë e të katit të dytë të objektit nr. 1, me sipërfaqe 396 (treqind e

nëntëdhjetë e gjashtë) m² dhe të objektit nr. 2, me sipërfaqe 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) m², pjesë të pronës nr. 1047, me emërtim “Qendër mobilizimi”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për administrimin, ruajtjen dhe përpunimin e dokumentacionit të Arkivit Qendror të Shtetit, deri në datën 31.12.2024.


2. Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, degës së Arkivit Shtetëror Vendor në Berat u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e objekteve të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t'i tjetërsojnë ose t'ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të nxjerrin aktet e nevojshme për dhënien në përdorim të objekteve, duke përcaktuar detyrimet për secilin institucion.


4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, drejtori i Përgjithshëm i Arkivave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



PLANIMETRIA E OBJEKTIT Nr.1 KATI I PARE
SIP e Ndertimit = 198 m²
SHKALLA 1:100



**VENDIM**

Nr. 116, datë 17.2.2016

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT,
FUNKSIONIMIT DHE PËRBËRJEN E
KOMISIONIT TË KUALIFIKIMIT TË
AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË
SEKTORIN PUBLIK DHE PËRCAKTIMIN
E TARIFAVE TË TRAJNIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 e 26, të ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Për përcaktimin e mënyrës së organizimit, funksionimit, përbërjes së komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik dhe të tarifave të trajnimit.

KREU I

**ORGANIZIMI DHE PËRBËRJA E
KOMISIONIT TË KUALIFIKIMIT TË
AUDITUESVE TË BRENDSHËM**

1. Komisioni i kualifikimit të audituesve të brendshëm është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të certifikimit dhe trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në



sektorin publik në varësi të ministrit të Financave.

2. Komisioni i kualifikimit të audituesve të brendshëm përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët emërohen nga ministri i Financave për një periudhë 2-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

3. Komisioni i kualifikimit të audituesve të brendshëm përbëhet nga anëtarë, të cilët kanë njohuri për auditimin e brendshëm, përkatësisht:

a) Një anëtar nga fusha e auditimit të brendshëm në sektorin publik;

b) Një anëtar nga fusha e legjislacionit në sektorin publik;

c) Një anëtar nga trupa e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë;

ç) Një anëtar nga fusha e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik;

d) Një anëtar nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.

4. Anëtarët e komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm duhet të përmbushin këto kritere:

a) Të kenë shtetësi shqiptare;

b) Të kenë integritet moral dhe profesional;

c) Të mos jenë dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;

ç) Të kenë përvojë pune mbi 5 vjet në profesion;

d) Të kenë diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve”;

dh) Përfaqësuesit e fushës së auditimit të jenë certifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.

5. Komisioni i kualifikimit të audituesve të brendshëm do të ketë përgjegjësitë në lidhje me kualifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik, sipas parashikimeve në rregulloren “Për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik” dhe në rregulloren “Për trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik”.

KREU II

FUNKSIONIMI DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT TË KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

1. Anëtarët e komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm, në mbledhjen e tyre të parë, zgjedhin kryetarin.

2. Komisioni i kualifikimit të audituesve të brendshëm zgjedh, ndërmjet anëtarëve të tij, zëvendëskryetarin, i cili, kur kryetari mungon ose është në pamundësi për të ushtruar funksionet, ushtron kompetencat e këtij të fundit.

3. Kur kryetari dhe zëvendëskryetari mungojnë apo janë në pamundësi për të ushtruar funksionet e tyre, mbledhja drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë.

4. Mbledhja e komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm thirret nga kryetari, jo më vonë se pesë ditë para datës së mbledhjes, duke u njoftuar anëtarëve rendin e ditës, të shoqëruar me materialet përkatëse.

5. Në raste të veçanta, komisioni i kualifikimit të audituesve të brendshëm mund të mblidhet me kërkesë të:

a) Ministrit të Financave;

b) Strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm;

c) Të paktën, tre anëtarëve të komisionit, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës.

6. Komisioni i kualifikimit të audituesve të brendshëm e zhvillon veprimtarinë sipas një kalendarit të miratuar në mbledhjen e parë të tij.

7. Sekretari i komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm caktohet nga drejtori i Përgjithshëm i strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm dhe përzgjidhet ndër punonjësit e kësaj strukture.

8. Mbledhja e komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.

9. Kryetari dhe çdo anëtar i komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm kanë të drejtën e një vote. Kryetari voton i fundit. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtë vote. Votimi është i hapur, me përjashtim të votimit për kryetarin, dhe, në asnjë rast, nuk lejohet abstenimi, ndërsa vota kundër argumentohet.

10. Ministri i Financave liron nga detyra anëtarët e komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm nëse mungojnë pa shkaqe të arsyeshme në pesë mbledhje, gjatë një periudhe 1-vjeçare.



11. Përfundimet e çdo mbledhjeje pasqyrohen në një memorandum, i cili i bëhet i ditur ministrit të Financave dhe, së bashku me procesverbalin e mbledhjes, depozitohen në protokollin e Ministrisë së Financave.

12. Periudha e zhvillimit të mbledhjeve përcaktohet sipas programeve të miratuara për proceset e certifikimit dhe trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik.

13. Kryetari dhe anëtarët e komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm shpërblehen në përputhje me aktet ligjore në fuqi, por jo më shumë se për 12 mbledhje në vit.

14. Komisioni i kualifikimit të audituesve të brendshëm ka këto përgjegjësi:

a) Mbikëqyr ecurinë e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik;

b) Mbikëqyr ecurinë e trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik.

c) Realizon të gjitha detyrat dhe merr vendime për procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik”, të miratuar nga ministri i Financave;

ç) Realizon të gjitha detyrat dhe merr vendime për procesin e trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik, në përputhje me rregulloren “Për trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik”, të miratuar nga ministri i Financave.

KREU III ZGJEDHJA E TRAJNERËVE DHE MBIKËQYRËSVE

1. Komisioni i kualifikimit të audituesve të brendshëm, në përputhje me procedurën e përcaktuar në rregulloret e parashikuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 14, të kreut II, të këtij vendimi, merr vendime për përzgjedhjen e trajnerëve dhe mbikëqyrësve që do të angazhohen në procesin e certifikimit dhe të trajnimit të vijueshëm profesional.

2. Pas përzgjedhjes së trajnerëve dhe mbikëqyrësve, nëpunësi i parë autorizues lidh me trajnerët dhe mbikëqyrësit një apo disa nga tipat e kontratave të përgatitura nga struktura përgjegjëse

për harmonizimin e auditimit të brendshëm, të përcaktuara si më poshtë:

a) Kontratë si trajner dhe korrigjues provimesh ose/dhe riprovimesh në procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik;

b) Kontratë si trajner në trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik;

c) Kontratë për hartimin e kurrikulave dhe materialeve të trajnimit për procesin e certifikimit ose/dhe trajnimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm;

ç) Kontratë për mbikëqyrësit e sallave të trajnimit.

3. Për efekt të pagesës, trajnerët me të cilët lidhet kontrata, sipas pikës 2, të kreut III, të këtij vendimi, ndahen në dy kategori:

a) Trajnerë të kategorisë së parë, trajnerë që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe 6–10 vite përvojë pune në fushën përkatëse, si dhe trajnerë që kanë një diplomë postmaster apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe, minimalisht, 3 vite përvojë pune në fushën përkatëse;

b) Trajnerë të kategorisë së dytë, trajnerë që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe mbi 10 vite përvojë pune në fushën përkatëse, ose trajnerë që kanë një gradë apo titull shkencor dhe, minimalisht, 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse.

4. Masa e pagesës për trajnerët përcaktohet në kontratë dhe llogaritet në varësi të kategorisë së trajnerit e të orëve të trajnimit, përkatësisht:

a) Për kontratat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të kreut III, të këtij vendimi, masa e pagesës për çdo orë trajnimi 60-minutëshe të jetë sipas lidhjes 1, që i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Për kontratat e parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 2, të kreut III, të këtij vendimi, masa e pagesës për hartimin e kurrikulave apo të materialeve të trajnimit, të nevojshme për zhvillimin e 6 orëve 60-minutëshe të jetë 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë;

c) Për rastet e hartimit të kurrikulave apo materialeve të trajnimit për më pak se 6 orë



trajnimi 60-minutëshe, pagesa të llogaritet në përpjesëtim me orët e trajnimit;

c) Në rastet e rishikimit të kurrikulave, pagesa të jetë deri në 50 për qind të pagesës së përcaktuar sipas shkronjës “b”, të kësaj pike.

5. Masa e pagesës për trajnerët e procesit të certifikimit që korrigjojnë provimet ose/dhe riprovimet përcaktohet në kontratë dhe llogaritet në varësi të numrit të fletoreve të korrigjuara, përkatësisht, 200 lekë për çdo fletore të korrigjuar.

6. Mbikëqyrësit e sallave të trajnimit duhet të jenë pjesë e administratës publike, me përjashtim të punonjësve të njësive të auditimit të brendshëm, të cilët zgjidhen nga nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

7. Masa e pagesës për mbikëqyrësit e sallave të trajnimit përcaktohet në kontratë, përkatësisht në masën 3 000 lekë për çdo mbikëqyrje provimi ose/dhe riprovimi.

KREU IV TARIFAT E PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT

1. Tarifat për procesin e certifikimit si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”, janë:

a) Për regjistrimin dhe pjesëmarrjen në procesin e certifikimit, 40 000 lekë;

b) Për pjesëmarrjen në çdo riprovim, 5 000 lekë.

2. Tarifat për trajnimin e vijueshëm profesional, janë:

a) Për pjesëmarrjen në trajnimin e vijueshëm profesional të audituesit të brendshëm të certifikuar, që ushtron detyrën si auditues i brendshëm, ky shërbim është pa pagesë;

b) Për pjesëmarrjen në trajnimin e vijueshëm profesional të audituesit të brendshëm të certifikuar, por që nuk ushtron detyrën si auditues i brendshëm, 10 000 lekë.

3. Të ardhurat që realizohen nga procesi i certifikimit dhe i trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik derdhen në buxhetin e shtetit.

4. Shpenzimet që do të kryhen për organizimin dhe zhvillimin e këtyre proceseve përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Financave.

5. Anëtarët e komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm emërohen brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Vendimi nr. 886, datë 19.12.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të komisionit të kualifikimit për certifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Lidhja 1

MASAT E PAGESAVE PËR TRAJNERËT

Kategoria e trajnerëve	Masa e pagesës
I	1 000 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi
II	1 500 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi

VENDIM

Nr. 117, datë 17.2.2016

PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE, PËR VITIN 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e numrit të punonjësve në njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2016, si më poshtë vijon:

a) Numri i punonjësve të Agjencisë së Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog shtohet me 5 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të institucioneve të tjera qendrore në 326 veta.

b) Numri i punonjësve të administratës së prefekturave reduktohet me 5 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme në 14 172 veta.

c) Numri i punonjësve të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale shtohet me 16 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të Ministrisë së Zhvillimit Urban në 532 veta.



ç) Numri i punonjësve të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) shtohet me 22 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të Kryeministrit në 552 veta gjithsej.

d) Numri i punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes reduktohet me 38 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të saj në 9 210 veta gjithsej.

2. Ngarkohen institucionet e përmendura më sipër dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 118, datë 17.2.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 23,
DATË 20.1.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
NUMRIT TË PUNONJËSVE ME
KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR
VITIN 2016 NË NJËSITË E QEVERISJES
QENDRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 23, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet “...1 751 veta ...”.

2. Në lidhjen nr. 1, përmendur në pikën 1 të vendimit, bëhen këto shtesa:

a) Në ndarjen “Gr.4 Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” dhe në ndarjen “Gr.13 Ministria e Shëndetësisë” shtohet nëndarja sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Emërtesa “Punonjës protokoll/arkivi”, e përmendur në ndarjen “Gr. 6 Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (aparati)”, bëhet “specialist arkivi” dhe emërtesa “punonjës mirëmbajtjeje”, përmendur në nëndarjen “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, bëhet “punonjës shërbimi”.

c) Pas ndarjes “Gr. 28 Prokuroria e Përgjithshme” shtohet ndarja “Gr. 29 Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në pikën 4, pas fjalëve “... si dhe mësuesit në dispozicion në arsimin parauniversitar dhe arsimin profesional” shtohen “... dhe pedagogë të jashtëm/trajnerë të angazhuar në formimin profesional të magjistratëve.”.

II. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve, kategorinë përkatëse të pagës dhe burimin e financimit të tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Tabela

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
04	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	6			
	<i>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</i>	4	Specialistë	8 orë/ditë	6-muaj
	<i>Agjencia Kombëtare e Bregdetit</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	<i>Agjencia Kombëtare e Turizmit</i>	1	Specialist	8 orë/ditë	6-muaj
13	Ministria e Shëndetësisë	2			
	<i>Spitali Psikiatrik Elbasan</i>	2	Kaldaistë	8 orë/ditë	janar-mars;nentor-dhjetor
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqësor	20			
	<i>Gjykata Shkallës Parë Krimit e Renda</i>	1	Sanitar	8 orë / ditë	6-muaj
	<i>Gjykata e Rrethit Durrës</i>	1	Nëpunës gjyqësor	8 orë / ditë	korrik - dhjetor
	<i>Gjykata e Rrethit Elbasan</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Elbasan</i>	1	Nëpunës gjyqësor	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Shkodër</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Shkodër</i>	1	Nëpunës gjyqësor	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Fier</i>	1	Nëpunës gjyqësor	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Fier</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Vlorë</i>	1	Nëpunës gjyqësor	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Vlorë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Korçë</i>	1	Nëpunës gjyqësor	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Korçë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Tiranë</i>	1	Sanitar	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Rrethit Tiranë</i>	1	Sekretar gjyqësor	4 orë/ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Apelit Tiranë</i>	1	Nëpunës gjyqësor	4 orë / ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Apelit Vlorë</i>	1	Sanitar	5 orë / ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë</i>	1	nëpunës gjyqësor	4 orë / ditë	vjetore
	<i>Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë</i>	1	Sekretar gjyqësor	4 orë / ditë	vjetore
	<i>Gjykata Administrative Shkallës Parë Durrës</i>	1	Sekretar gjyqësor	4 orë / ditë	vjetore
	<i>Gjykata Administrative Shkallës Parë Tiranë</i>	1	Sekretar gjyqësor	4 orë / ditë	vjetore

VENDIM

Nr. 119, datë 17.2.2016

PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PRAKTIKANTËVE PËR KRYERJEN E PRAKTIKËS PROFESIONALE, ME KONTRATË TË PËRKOHSHE, PËR PERIUDHËN 1 JANAR – 15 QERSHOR 2016 DHE 15 SHTATOR – 31 DHJETOR 2016, PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 57, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për periudhën 1 janar–15 qershor 2015 dhe periudhën 15 shtator–31 dhjetor 2016 është 1 500 (një mijë e pesëqind) praktikantë.

2. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, sipas njësive arsimore vendore dhe afati kohor i kontraktimit të praktikantëve është sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Praktikantët gjatë periudhës së kryerjes së praktikës profesionale përfitojnë çdo muaj nga punëdhënësi (njësitë arsimore vendore) pagesën e përlllogarit mbi bazën e pagës minimale mujore prej 22 000 (njëzet e dy mijë) lekësh, miratuar me vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, për sigurimet shoqërore në masën 24.5% të pagës bruto dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor në masën 3.4% të pagës bruto.



4. Efektet financiare për pagesën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për vitin 2016, të përlogaritura në emër të punëdhënësit e të punëmarrësit, në shumën 82 863 000 (tetëdhjetë e dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2016, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Tabela nr. 1. Numri i praktikantëve “Për kryerjen e praktikës profesionale”, me kontratë të përkohshme, sipas njësive arsimore vendore dhe afati kohor i kontraktimit të praktikantëve për vitin 2016

Kodi i institucionit	Emërtimi i institucionit arsimore (njësitë arsimore vendore)	Numri i praktikantëve me kontratë të përkohshme për periudhën 01 janar – 15 qershor 2016	Numri i praktikantëve me kontratë të përkohshme për periudhën 15 shtator – 31 dhjetor 2016
1011002	Drejtoria Arsimore Rajonale Berat	56	56
1011006	Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër	40	40
1011007	Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës	86	86
1011008	Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan	104	104
1011009	Drejtoria Arsimore Rajonale Fier	83	83
1011011	Drejtoria Arsimore Rajonale	21	21
1011015	Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë	63	63
1011018	Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës	37	37
1011020	Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë	35	35
1011033	Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër	90	90
1011035	Drejtoria Arsimore e Qytetit Tiranë	157	157
1011036	Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë	67	67
1011038	Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë	74	74
1011088	Zyra Arsimore Kuçovë	15	15
1011089	Zyra Arsimore Skrapar	13	13
1011090	Zyra Arsimore Bulqizë	20	20
1011092	Zyra Arsimore Mat	31	31
1011096	Zyra Arsimore Krujë	32	32
1011100	Zyra Arsimore Gramsh	22	22
1011101	Zyra Arsimore Librazhd	40	40
1011102	Zyra Arsimore Peqin	16	16
1011105	Zyra Arsimore Lushnjë	66	66
1011106	Zyra Arsimore Mallakastër	16	16
1011109	Zyra Arsimore Përmet	14	14
1011110	Zyra Arsimore Tepelenë	19	19
1011111	Zyra Arsimore Devoll	14	14
1011112	Zyra Arsimore Kolonjë	8	8
1011117	Zyra Arsimore Pogradec	37	37
1011118	Zyra Arsimore Has	12	12
1011120	Zyra Arsimore Tropojë	20	20



1011121	Zyra Arsimore Kurbin	26	26
1011123	Zyra Arsimore Mirditë	18	18
1011124	Zyra Arsimore Malësia e Madhe	20	20
1011125	Zyra Arsimore Pukë	16	16
1011130	Zyra Arsimore Kavajë	36	36
1011132	Zyra Arsimore Delvinë	7	7
1011133	Zyra Arsimore Sarandë	16	16
1011159	Zyra Arsimore Kamzë, Tiranë	51	51
	TOTALI	1,500	1,500

VENDIM**Nr. 120, datë 17.2.2016**

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT
TË MENAXHIMIT TË KONTRIBUTEVE
TË SIGURIMEVE SHOQËRORE (CMIS)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është krijimi i bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të kontributeve, e quajtur CMIS.

2. CMIS-i administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

3. Përbërësit e arkitekturës *software* dhe *hardware* të sistemit miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.

4. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen ato që grumbullohen nga vetë kjo bazë të dhënash, të cilat përfshijnë:

- periudhën kontributive;
- kërkesat për sigurim (numrin dhe datën);
- periudhën e siguruar (periudha, datat);
- shumën e derdhur e të vetësiguruarve.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen ato që merren nga baza të tjera të dhënash, të dhëna referenciare nga regjistri i Gjendjes Civile dhe regjistri i Tatimeve:

- numrin e identifikimit NID;
- emri;
- mbiemri;

- atësia;
- emri i nënës;
- datëlindja;
- vendlindja;
- mbiemri i vajzërisë;
- ZGJC_CODE;
- punëdhënësi;
- periudha e siguruar;
- shuma e derdhur.

5. Dhënës të informacionit janë:

- a) qytetarët, përfitues të skemave;
- b) drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore;
- c) Drejtoria e Tatimeve;
- ç) baza e të dhënave të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile.

6. Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të CMIS-it është, si më poshtë vijon:

- a) Qytetarët kanë vetëm të drejtë të marrin informacion, duke patur mjet identifikimi;
- b) Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka të drejtë të plota administrative mbi bazën e të dhënave dhe sistemin, në rolet:
 - i) administrator;
 - ii) raportues;
 - iii) auditues;
 - iv) zhvillues.

c) Subjektet e tjera, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave, mund të kenë akses në nivelin raportues apo statistikor, për të monitoruar apo për të raportuar.

7. CMIS-i ndërvepron me bazën e të dhënave të RKGJC-së dhe të DPT-së vetëm me të dhënat parësore.

Proceset e punës në bazën e të dhënave të CMIS-it përcaktohen me rregullore të brendshme ose me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të ISSH-së, në përputhje me rregullat e miratuara në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.



8. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe strukturat në varësi të tij për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 121, datë 17.2.2016

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT
TË ARKIVIMIT DHE MENAXHIMIT TË
DOKUMENTEVE TË VJETËRSISË NË
PUNË DHE TË PERIUDDHAVE TË
SIGURIMIT (DMAIS)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të arkivimit dhe menaxhimit të dokumenteve të vjetërsisë në punë dhe të periudhave të sigurimit (DMAIS).

2. DMAIS-ja administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

3. Përbërësit e arkitekturës, *software* dhe *hardware* të sistemit, miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.

4. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen ato të dhëna të cilat grumbullohen nga vetë kjo bazë të dhënash, si:

- pozicioni i punës;
- afatet e qëndrimit në punë.

b) Të dhëna dytësore nuk ka, si të tilla konsiderohen të dhënat që merren nga baza të tjera të dhënash.

5. Dhënës i informacionit është Arkivi Qendror i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

6. Niveli i aksesimit në sistemin dhe bazën e të dhënave të DMAIS-së është, si më poshtë vijon:

a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka të drejta të plota administrative mbi bazën e të dhënave dhe sistemin në rolet e:

- i) administratorit;
- ii) raportuesit;
- iii) audituesit;
- iv) zhvilluesit.

b) Subjektet e tjera, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave, mund të kenë akses në nivelin raportues apo statistikor, për të monitoruar apo për të raportuar.

7. Ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave shtetërore dhe proceset e punës në bazën e të dhënave të DMAIS-së përcaktohen me rregullore të brendshme ose me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në përputhje me rregullat në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.

8. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe strukturat në varësi të tij për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 122, datë 17.2.2016

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT
TË MENAXHIMIT, TË KALKULIMIT
DHE PAGESËS SË PËRFITIMIT (PCAMS)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit, të kalkulimit dhe pagesës së përfitimeve, të quajtur PCAMS.

2. PCAMS-ja administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

3. Përbërësit e arkitekturës, *software* dhe *hardware* të sistemit, miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.



4. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore dhe të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen ato të dhëna të cilat grumbullohen nga vetë kjo bazë të dhënash dhe përfshijnë:

- periudhën kontributive;
- dokumentet e nevojshme të skanuara;
- kërkesat për caktim pensioni (numrin dhe datën);
- kërkesat për rishqyrtim pensioni (numrin, datën dhe arsyen);
- kërkesat për transferim pensioni (numrin, datën);
- llojin e pensionit;
- masën e pensionit;
- datën e fillimit të pensionit;
- pikën paguese të pensionit.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që merren nga baza të tjera të dhënash dhe përfshijnë të dhënat referencare nga regjistri i Gjendjes Civile, si: numrin e identifikimit, emrin, mbiemrin, atësinë, emrin e nënës, vendlindjen, datëlindjen, mbiemrin e vajzërisë, ZGJC_CODE.

5. Subjektet përgjegjëse të PCAMS-së janë si më poshtë vijon:

- a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- b) Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore përkatëse;
- c) Degët e sigurimeve shoqërore;
- ç) Agjencia Rajonale e Sigurimeve Shoqërore përkatëse.

6. Dhënës të informacionit janë:

a) Qytetarët të cilët plotësojnë kushtet për përfitim;

b) Drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore;

7. Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të PCAMS-së është, si më poshtë vijon:

a) Qytetarët kanë të drejtë të marrin informacion vetëm duke pasur një mjet identifikimi;

b) Shërbimi social ka vetëm të drejtë të lexojë dhe të marrë informacion për çdo individ që është në bazën e të dhënave;

c) Institucionet që kryejnë pagesat kanë vetëm të drejtë të lexojnë dhe të kryejnë pagesat;

ç) Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka të drejta të plota administrative mbi bazën e të dhënave dhe sistemin në rolet e:

i) administratorit;

ii) raportuesit;

iii) audituesit;

iv) zhvilluesit.

d) Subjektet e tjera, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave, mund të kenë akses në nivelin raportues apo statistikor për të monitoruar apo për të raportuar.

8. PCAMS-ja ndërvepron me bazën e të dhënave të RKGJC-së vetëm me të dhënat parësore.

Proceset e punës në bazën e të dhënave të PCAMS-së përcaktohen me rregullore të brendshme ose me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në përputhje me rregullat në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.

9. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe strukturat në varësi të tij për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 123, datë 17.2.2016

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE
CIVILË/NËPUNËSVE,
ZËVENDËSMINISTRIT DHE
NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË
KRYEMINISTRI, APARATET E
MINISTRIVE TË LINJËS,
ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT,
KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E
PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE
TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË
VARËSI TË KRYEMINISTRIT,
INSTITUCIONET NË VARËSI TË
MINISTRAVE TË LINJËS DHE
ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të



shpërblimeve”, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1/3 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

i) Në shkronjën “a” shtohet emërtesa “Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial”.

ii) Në shkronjën “b”, emërtesa “Inspektorati Qendror Teknik”, shfuqizohet.

iii) Në shkronjën “c” shtohet emërtesa “Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme”.

b) Në fund të lidhjes nr. 3, që përmendet në pikën 3, shtohet ndarja me këtë përmbajtje:

“Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – Inspektor – kategoria III-a.”.

c) Në pikën 4/1, pas fjalëve “Teknologji informacioni” shtohen “Informatikë ekonomike”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i përcaktimeve të shkronjës “a”, nënndarjet “i”, “ii”, “iii” dhe “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, të fillojnë nga data e emërimit të nëpunësve/punonjësve në detyrë dhe, për vitin 2016, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2016.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i përcaktimit të shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, të fillojnë nga data 1 janar 2016.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 124, datë 17.2.2016

**PËR PEZULLIMIN DHE LIRIMIN
NGA SHËRBIMI CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 55, pika 2, 56, pika 5, e 66, pika 5, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim rregullon procedurat për pezullimin nga shërbimi civil të nëpunësve civilë të të gjitha kategorive dhe lirimnin nga shërbimi civil për nivelin ekzekutiv, të ulët dhe të mesëm drejtues.

KREU I
PEZULLIMI

2. Pezullimi i marrëdhënies në shërbimin civil bëhet në këto raste:

a) Për shkak të njëres prej arsyeve të pezullimit, sipas nenit 54, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar;

b) Me kërkesë të vetë nëpunësit;

c) Në rastin e procedimit disiplinor sipas pikës 6, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

3. Pezullimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkaqet e parashikuara në nenin 54, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, bëhet me konstatimin e shkakut të ligjshëm të pezullimit nga njësia e burimeve njerëzore. Për TND-në, konstatimi i pezullimit bëhet nga DAP-i me marrjen dijeni për shkakun e pezullimit.

4. Eprori direkt dhe çdo nëpunës civil, kur kanë dijeni për shkaqet e ligjshme të pezullimit, të parashikuara në nenin 54, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, kanë detyrimin të njoftojnë njësinë e burimeve njerëzore të institucionit ku është i punësuar nëpunësi.

5. Njësia e burimeve njerëzore nis procedurën e verifikimit me marrjen dijeni të shkakut të pezullimit. Njësia e burimeve njerëzore njofton nëpunësin civil brenda 2 (dy) ditëve nga data e konstatimit të shkakut të ligjshëm të pezullimit.

6. Nëpunësi civil dëgjohet nga njësia e burimeve njerëzore brenda 3 (tri) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.



7. Konstatimi i pezullimit bëhet nga njësia e burimeve njerëzore brenda 2 (dy) ditëve, pas ndjekjes së procedurës në pikat 4, 5 dhe 6, të këtij vendimi.

8. Në rastin e TND-së, DAP-i njofton anëtarin e TND-së brenda 2 (dy) ditëve nga data e konstatimit të shkakut të ligjshëm të pezullimit.

9. Anëtari i TND-së dëgjohet nga DAP-i brenda 3 (tri) ditëve nga data e marrjes së njoftimit. DAP-i pasi dëgjon nëpunësin civil vendos për pezullimin brenda 2 (dy) ditëve.

10. Nëpunësi civil me kërkesën e tij mund të kërkojë pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil në këto raste:

a) Kur zhvillon veprimtari në kuadër të organizatave apo institucioneve ndërkombëtare në raste të tjera nga ato të parashikuara në pikën 6, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vërtetuar me dokumentin përkatës të angazhimit në këto veprimtari;

b) Për periudha studimi më shumë se 1 muaj deri në 2 vjet, vërtetuar me dokumentin përkatës të ndjekjes së studimeve;

c) Për shkak të një interesi tjetër të ligjshëm, për një periudhë deri në 2 vjet, sipas përcaktimit në pikën 12, të këtij vendimi.

Pezullimi me kërkesën e nëpunësit civil sipas kësaj pike nuk bëhet për nëpunësit civilë në periudhë prove dhe nëpunësit civilë të emëruar në pozicione të nivelit të ulët apo të mesëm drejtues, të rekrutuar nga jashtë sistemit të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të cilët nuk kanë plotësuar të paktën një vit pune në pozicionin në të cilin janë emëruar.

11. Kërkesa për pezullim për një nga rastet e parashikuara në pikën 10 të këtij vendimi, bëhet me shkrim 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së kërkuar për pezullim. Kërkesa i drejtohet njësisë së burimeve njerëzore, ndërsa në rastin e anëtarëve të TND-së kërkesa i drejtohet DAP-it.

12. Kërkesa që paraqet nëpunësi civil për rastin e parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 10, të këtij vendimi, duhet të jetë e motivuar. Ai mund të bëjë kërkesë për pezullim për rastet e mëposhtme:

a) Për arsye shëndetësore të tij apo të njerëzve të afërm të tij, të vërtetuar me dokument të lëshuar nga institucioni shëndetësor brenda ose jashtë vendit;

b) Për punësim në aktivitet privat/organizata jofitimprurëse brenda ose jashtë vendit, të vërtetuar me kontratën e punës të lidhur me punëdhënësin;

c) Për punësim në një pozicion të paktën të njëjtë nivel në një institucion të administratës publike që nuk është pjesë e fushës së veprimit të legjislacionit të nëpunësit civil;

ç) Për punësim si ekspert në projekte të ndryshme brenda ose jashtë vendit, të vërtetuar me kontratën përkatëse.

13. Pas kërkesës së nëpunësit civil, njësia e burimeve njerëzore dhe DAP-i, sipas rastit, konstatojnë me shkrim pezullimin brenda 10 (dhjetë) ditëve.

14. Për institucionet e administratës shtetërore, njësia e burimeve njerëzore njofton njësinë përgjegjëse për pezullimin e nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët apo të mesme drejtuese, brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e konstatimit të pezullimit.

KREU II PËRFUNDIMI I PERIUDHËS SË PEZULLIMIT

15. Në përfundimin e periudhës së pezullimit, nëpunësi civil që ka qenë i pezulluar për një afat deri në 3 muaj, rikthehet në pozicionin e tij të punës. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit njofton njësinë përgjegjëse për kthimin e nëpunësit civil brenda 3 (tri) ditëve kalendarike.

16. Në përfundim të periudhës së pezullimit për rastet e pezullimit për një afat më të gjatë se 3 muaj, nëpunësi civil që ka qenë i pezulluar njofton njësinë përgjegjëse për përfundimin e pezullimit.

17. Njësia përgjegjëse, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit vendos:

a) Rikthimin e nëpunësit civil në pozicionin e mëparshëm të punës, nëse ky pozicion është vakant, duke nxjerrë edhe aktin e rikthimit;

b) Transferimin në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, nëse pozicioni i mëparshëm i punës është plotësuar nëpërmjet procedurave të pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, duke nxjerrë aktin e transferimit;

c) Regjistrimin e nëpunësit civil në listën e krijuar sipas përcaktimeve të nenit 56, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke njoftuar nëpunësin civil për regjistrimin në listë dhe arsyet e pamundësisë së zbatimit të



procedurës së parashikuar në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike.

18. Në momentin e krijimit të një vendi të lirë në shërbimin civil, njësia përgjegjëse është e detyruar të nxjerrë aktin e transferimit në këtë pozicion për njërin nga nëpunësit e regjistruar në listë dhe që plotëson kriteret përkatëse të vendit vakant. Transferimi në atë pozicion bëhet me precedencë sipas kësaj renditjeje:

a) Nëpunësi me kohëzgjatje më të madhe të qëndrimit në listë;

b) Nëse ka më shumë se 1 nëpunës me të njëjtën kohëzgjatje të qëndrimit në listë, nëpunësi me vjetërsi më të madhe në shërbimin civil;

c) Nëse ka më shumë se 1 nëpunës civil me të njëjtën vjetërsi në shërbimin civil, nëpunësi me më shumë vlerësime pozitive të rezultateve në punë si nëpunës civil.

19. Nëpunësi civil, për të cilin njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e transferimit, ka të drejtë të refuzojë transferimin vetëm për shkaqet e mëposhtme:

a) Kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;

b) Nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil.

20. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përveç pikës 19 të këtij vendimi, përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil.

KREU III LIRIMI NGA SHËRBIMI CIVIL

21. Nëpunësi civil lirohet nga shërbimi civil për shkaqet e parashikuara nga neni 66, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me deklarimin e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën. Në rastin e institucioneve të administratës shtetërore, njësia e burimeve njerëzore njofton DAP-in për vendimin e liritimit nga shërbimi civil të nëpunësve të kategorisë ekzekutive, të ulët apo të mesme drejtuese, brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit.

22. Lirimi nga shërbimi civil bëhet automatikisht menjëherë pas dy vlerësimeve negative radhazi nga njësia e burimeve njerëzore dhe i njoftohet menjëherë nëpunësit. Vlerësim negativ konsiderohet vlerësimi “jokënaqshëm”.

23. Nëpunësi civil lirohet nga shërbimi civil kur bëhet i paaftë përgjithmonë për të kryer detyrat për shkak të gjendjes shëndetësore. Paaftësia shëndetësore dokumentohet nga njësia e burimeve njerëzore, në bazë të vërtetimit të lëshuar nga KMCAP-ja.

Nëpunësi civil paraqet pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dokumentin e shëndetit në punë, sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë, brenda datës 10 janar të çdo viti.

24. Në rastet e liritimit për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, njësia e burimeve njerëzore të institucionit deklaron vendimin për lirimin nga shërbimi civil të nëpunësit civil, bazuar në njoftimin e Komisionit të Ristrukturimit ngritur për ristrukturimin apo mbylljen e institucionit.

25. Njësia e burimeve njerëzore deklaron vendimin për lirimin nga shërbimi civil të nëpunësit civil për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 66, të ligjit nr. 152/2013, menjëherë me konstatimin e tyre. Të drejtën për të propozuar pranë njësisë për burimet njerëzore lirimin nga shërbimi civil të nëpunësit civil e ka edhe eprori direkt. Në këtë rast, njësia e burimeve njerëzore deklaron vendimin për lirimin nga shërbimi civil të arsyetuar 3 (tri) ditë pas propozimit të eprorit direkt.

26. Lirimi nga shërbimi civil i anëtarëve të TND-së rregullohet nga vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave për TND-në.

27. Nëpunësi që largohet nga shërbimi civil duhet të bëjë të gjitha veprimet e duhura për dorëzimin e detyrës në mënyrë korrekte dhe në përputhje me etikën e nëpunësit civil.

28. Nëpunësi duhet të bëjë tek eprori direkt dorëzimin e plotë të dokumentacionit që ka për shkak të detyrës, si dhe të njësia përgjegjëse për mbajtjen e inventarit fizik, dorëzimin e pajisjeve e të mjeteve të punës në inventar.

29. Dorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar bëhet, si rregull, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të liritimit. Në raste të veçanta, me urdhër të eprorit direkt, ky afat mund të zgjatet edhe me 5 (pesë) ditë të tjera.

30. Mosdorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar brenda afateve të përcaktuara në pikën 29, të këtij vendimi,



konsiderohet shkelje e rëndë e detyrës dhe shkelje e rëndë disiplinore.

31. Nëpunësit civilë që lirohen për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, në momentin e largimit përfitojnë dëmshpërblimin përkatës sipas përcaktimeve të pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

32. Nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative dhe gjyqësore sipas rregullave të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative dhe legjislacioni në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

33. Përcaktimet e vendimit nr. 171, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, në lidhje me pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM Nr. 125, datë 17.2.2016

PËR TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM DHE TË PËRHERSHËM TË NËPUNËSVE CIVILË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 48, pika 7, 50, pika 9, 51, pika 3, e 52, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim rregullon procedurat për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, për nivelin ekzekutiv, të ulët dhe të mesëm drejtues.

KREU I TRANSFERIMI I PËRKOHSHËM

2. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil

të së njëjtës kategori, sipas rastit, përkatësisht brenda institucionit ku është emëruar, përfshirë edhe degët e tij territoriale, në një institucion të varësisë së institucionit ku është emëruar, në një institucion tjetër të shërbimit civil:

a) Në interes të institucionit, deri në 6 (gjashtë) muaj me/ose pa ndërprerje, gjatë 2 viteve;

b) Për përmirësimin e rezultateve të tij, deri në 3 (tre) muaj pa ndërprerje gjatë 2 viteve;

c) Për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë, të përcaktuara nga komisioni kompetent në bazë të ligjeve në fuqi, për aq sa është e nevojshme sipas vendimit të komisionit përkatës.

3. Në rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, transferimi i përkohshëm nuk bëhet për:

a) Nëpunësit civilë në periudhë prove;

b) Nëpunësit civilë të emëruar në pozicione të nivelit të ulët apo të mesëm drejtues, të rekrutuar nga jashtë sistemit të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të cilët nuk kanë plotësuar të paktën një vit pune në pozicionin në të cilin janë emëruar.

Në kuptim të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, në periudhën 2-vjeçare të viteve të punës nuk përfshihet koha e periudhës së provës.

4. Nëpunësi civil mund të transferohet në interes të institucionit me kërkesë të institucionit, drejtorisë së interesuar apo njësisë së burimeve njerëzore. Në rastet kur nëpunësi civil kërkohet të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, të ndryshëm nga institucioni ku ai është i emëruar, institucioni që paraqet kërkesën për transferimin e përkohshëm duhet të marrë paraprakisht miratimin e institucionit ku nëpunësi civil është i emëruar.

5. Transferimi i përkohshëm, në bazë të shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozicionit të punës ku ai kërkohet të transferohet, si dhe në plotësimin e kushteve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe në këtë vendim.



6. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht, për nevojat e institucionit apo shtetit, në një organizatë ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është anëtare apo në një institucion ndërkombëtar. Kërkesa bëhet nga organi i emërtesës në këtë institucion apo organizatë dhe miratohet nga njësia përgjegjëse.

7. Nëpunësi civil mund të transferohet për përmirësimin e rezultateve të tij në bazë të planeve vjetore të mobilitetit brenda institucionit dhe në bazë të planeve vjetore të mobilitetit të përgjithshëm për administratën shtetërore. Transferimi bëhet me kërkesë të tij dhe të eprorit direkt ose me kërkesë të secilit prej tyre dhe miratohet nga njësia përgjegjëse.

Plani vjetor i mobilitetit, në kuptim të kësaj pike, është plani i transferimeve të përkohshme në rast të nevojës së institucionit ose përmirësimit të rezultateve në punë.

8. Transferimi për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë bëhet me kërkesë të nëpunësit civil apo njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme të punës për këta nëpunës dhe miratohet nga njësia përgjegjëse.

9. Nëpunësi civil ka të drejtë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, të refuzojë me shkrim transferimin e përkohshëm pranë njësisë përgjegjëse dhe të dëgjohet prej saj, nëse:

a) Gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;

b) Vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil.

10. Njësia përgjegjëse merr vendim brenda 10 (dhjetë) ditëve pas afatit të përcaktuar në pikën 9, të këtij vendimi. Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës dhe përveç rasteve të parashikuara në pikën 9, të këtij vendimi, është i detyrueshëm.

11. Institucionet ku bëhet transferimi, mënyra e pagesës dhe rikthimi në vendin e punës bëhen sipas përcaktimeve të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

12. Kthimi në vendin e punës bëhet nga njësia përgjegjëse pas mbarimit të afateve të parashikuara në vendimin e njësisë përgjegjëse dhe jo më vonë se afatet e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

KREU II

TRANSFERIMI PËR SHKAK TË MBYLLJES DHE RISTRUKTURIMIT TË INSTITUCIONIT

13. Në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit do të konsiderohen ndryshime të vendit të punës rastet në të cilat, për efekt të ristrukturimit të ndodhur në institucion:

a) Janë shkurtuar vende pune;

b) Janë ristrukturuar vende pune;

c) Kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës.

14. Në këto raste nëpunësit mund të sistemohen në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuara apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit.

15. Nëpunësit e institucionit të ristrukturuar apo të mbyllur njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore për fillimin e procedurës së transferimit apo përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, në momentin e miratimit të aktit të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit. Efektet financiare për nëpunësit që do të transferohen apo do t’u përfundojë marrëdhënia e punësimit, fillojnë jo më shpejt se 1 (një) muaj nga momenti i njoftimit.

16. Në rastet e mbylljes apo ristrukturimit, njësia përgjegjëse krijon një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori apo përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësit.

17. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë dhe krijohet nga njësia përgjegjëse sipas rastit. Komisioni i ristrukturimit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e ristrukturimit.

a) I propozon me shkrim njësisë përgjegjëse transferimin e nëpunësit civil sipas precedencës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar;

b) Vlerëson dhe merr vendim për rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për arsyet e parashikuara në pikën 6, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të cilin ia dërgon njësisë së burimeve njerëzore të institucionit.



18. Komisioni i ristrukturimit në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve civilë për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit mbështetet në kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara të reja si pasojë e ristrukturimit dhe të dhënat e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve preken si pasojë e ristrukturimit. Vendimi është individual për çdo nëpunës civil.

19. Komisioni i ristrukturimit në vendimin e tij për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit mbështetet mbi këto kriteret:

- a) Vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil;
- b) Vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë;
- c) Vlerësimin e fundit që ka pasur nëpunësi në testimin për përfitim dhe përditësimin e njohurive shtesë.

20. Njësia përgjegjëse, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së propozimit nga komisioni i ristrukturimit, vendos për transferimin e nëpunësit civil, njofton nëpunësin civil për vendimin dhe merr mendimin e tij me shkrim. Nëpunësi civil duhet të japë mendimin e tij me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

21. Nëpunësi ka të drejtë të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga njësia përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin, vetëm në rast se:

- a) Gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;
- b) Vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil.

22. Njësia përgjegjëse verifikon shkaqet e refuzimit dhe mund të revokojë vendimin nëse plotësohen kushtet e pikës 20 të vendimit.

23. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përveç pikës 20 të këtij vendimi, përbën shkak për lirin nga shërbimi civil.

KREU III

TRANSFERIMI I PËRHERSHËM PËR ARSYE TË PAAFTËSISË SHËNDETËSORE

24. Eprori direkt ose vetë nëpunësi civil mund të kërkojnë transferimin në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori ku është i aftë të kryejë detyrat.

25. Nëpunësi civil që kërkon të transferohet i paraqet njësia përgjegjëse një kërkesë me shkrim dhe vërtetim të gjendjes shëndetësore, të siguruar

sipas legjislacionit në fuqi. Njësia përgjegjëse njofton eprorin direkt për kërkesën e nëpunësit.

26. Eprori direkt ka të drejtë të kërkojë nga njësia përgjegjëse transferimin e nëpunësit civil nëpërmjet një kërkesë të arsyetuar. Nëpunësi civil dëgjohet nga njësia përgjegjëse përpara se të marrë vendim dhe i paraqet asaj vërtetimin e gjendjes shëndetësore.

27. Për institucionet e administratës shtetërore, DAP-i merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga eprori direkt ose nëpunësi civil dhe vendos për transferimin në një nga këto institucione:

- a) Në një pozicion tjetër të të njëjtit institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar;
- b) Në institucionet e varësisë së institucionit ku nëpunësi është emëruar;
- c) Në një institucion tjetër të shërbimit civil.

28. Për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, njësia përgjegjëse merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga eprori direkt dhe vendos për transferimin e nëpunësit brenda institucionit.

KREU IV

TRANSFERIMI I PËRHERSHËM PËR SHKAK TË SHMANGIES SË KONFLIKTIT TË VAZHDUESHËM TË INTERESIT

29. Në institucionet qendrore, eprori direkt, vetë nëpunësi civil ose njësia e burimeve njerëzore mund të kërkojnë transferimin në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori ose, me miratimin e nëpunësit, në një kategori më të ulët, me qëllim shmangien e konfliktit të vazhdueshëm të interesit a të konflikteve të tjera të parashikuara në legjislacionin për konfliktin e interesit.

30. Në institucionet e qeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura kërkesa mund të bëhet nga eprori direkt ose vetë nëpunësi civil.

31. Nëpunësi civil që kërkon të transferohet i paraqet njësia përgjegjëse një kërkesë me shkrim dhe deklaron konfliktin e interesit. Njësia përgjegjëse njofton eprorin direkt për kërkesën e nëpunësit.

32. Eprori direkt ka të drejtë të kërkojë nga njësia përgjegjëse transferimin e nëpunësit civil nëpërmjet një kërkesë të arsyetuar. Nëpunësi civil dëgjohet nga njësia përgjegjëse përpara se të marrë vendim.



33. Për institucionet e administratës shtetërore, DAP-i merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga eprori direkt ose nëpunësi civil dhe vendos për transferimin në një nga këto institucione:

a) Në një pozicion tjetër të të njëjtit institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar;

b) Në institucionet e varësisë së institucionit ku nëpunësi është emëruar;

c) Në një institucion tjetër të shërbimit civil.

34. Për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, njësia përgjegjëse merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga eprori direkt dhe vendos për transferimin e nëpunësit brenda institucionit.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

35. Nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative dhe gjyqësore sipas rregullave të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative dhe legjislacioni në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

36. Vendimi nr. 171, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM Nr. 126, datë 17.2.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, DHE MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË PASURIVE QË PREKEN NGA SHESHET E DEPOZITIMIT/MAGAZINIMIT TË TUBAVE DHE KAMPEVE TË PUNËTORËVE, STACIONET E KOMPRESORËVE DHE VALVULAT E BLOKIMIT (PJESË E PROJEKTIT TAP)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 7 e 8, të pjesës së parë e të dytë të shtojcës 1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës,

ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive që preken nga sheshet e depozitimit/magazinimit të tubave dhe kampeve të punëtorëve, stacionet e kompresorëve dhe valvulat e bllokimit (pjesë e projektit TAP), sipas listave nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të shtetit, përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, dhe ata, të cilëve pronat u merren në përdorim të përkohshëm, të kompensohen në vlerë të plotë, për sipërfaqet 149 693.69 (njëqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre pikë gjashtëdhjetë e nëntë) m², e cila merret në përdorim të përkohshëm, dhe 140 476.88 (njëqind e dyzet mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë e tetë) m², e cila shpronësohet, me shumën 130 640 628.37 (njëqind e tridhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë pikë tridhjetë e shtatë) lekë, sipas të dhënave të përcaktuara në listat nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Vlera totale, prej 130 640 628.37 (njëqind e tridhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë pikë tridhjetë e shtatë) lekësh, dhe vlera e shpenzimeve procedurale të



përballohen nga shoqëria TAP AG, si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

5. Për likuidimin, për efekt shpronësimi dhe të marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurive, të përcaktuara në listat nr. 1 dhe nr. 2, të procedohet, si më poshtë vijon:

a) Për të gjitha pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, pronarët përkatës të likuidohen, për efekt shpronësimi dhe të marrjes në përdorim të përkohshëm, pas dorëzimit të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të lëshohet nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pranë TAP AG;

b) Për të gjitha pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “ZVRPP-ja konfirmon se nuk është lëshuar certifikata e pronësisë”, pronarët përkatës të likuidohen, për efekt shpronësimi dhe të marrjes në përdorim të përkohshëm, pas lëshimit të dokumentacionit të plotë të pronësisë nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;

c) Për të gjitha pasuritë, për të cilat është bërë shënimi “ZVRPP-ja konfirmon se pasuria figuron e inskriptuar dhe me masë sekuestro nga përmbarimi”, pronarët përkatës të likuidohen, për efekt shpronësimi dhe të marrjes në përdorim të përkohshëm, pas heqjes së masës së sekuestros, e konfirmuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe lëshimit të dokumentacionit të plotë të pronësisë.

6. Çdo pronar, për t’u likuiduar për efekt shpronësimi dhe të marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurive, të dorëzojë pranë shoqërisë TAP AG dokumentacionin e plotë të pronësisë, vërtetimin bankar, lidhur me numrin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit, të shoqëruar me një kërkesë.

7. Çdo përdorues të likuidohet, për efekt shpronësimi dhe të marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurive, në bazë të kopjes së dokumentit të identifikimit, vërtetimit bankar, lidhur me numrin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe të certifikatës familjare, që dorëzon pranë shoqërisë TAP AG.

8. TAP AG, dega Shqipëri, të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi dhe të marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurive, në bazë të pikave 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Korçë, Devoll, Skrapar, Berat dhe Fier, të pezullojnë të gjitha transaksionet për pasuritë, sipas listave bashkëlidhur, deri në momentin që do të realizohet kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuar, dhe regjistrimi i marrjes në përdorim të përkohshëm, në favor të shtetit.

10. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Korçë, Devoll, Skrapar, Berat dhe Fier, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së projektit, që do t’u vihet në dispozicion nga shoqëria TAP AG.

11. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë, shoqëria TAP AG, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Korçë, Devoll, Skrapar, Berat dhe Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



RRETHI DEVOLL, KORÇË, SKRAPAR, BERAT, FIER

LISTA NR. 1 - LISTA E PRONARËVE TË CILËT PREKEN NGA SHESHET E DEPOZITIMIT/MAGAZINIMIT TË TUBAVE DHE KAMPEVE TË PUNËTORËVE, STACIONET E KOMPRESORËVE DHE VALVULAT E BLOKIMIT

Nr.	Pronari			ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. m ² për marrje në përdorim të përkohshëm	Çmimi /m ²	Vlera/lekë	Sip. m ² shpronësi m	Çmimi/m ²	Vlera e tokës	Vlera totale e kulturave	Vlera totale lekë	Indeksi i hartës	Shënime
1	Safet	Kadri	Himi	1678	169/21	arë	612.78	207.00	126,845.46				20,179.96	147,025.42	K-34-125-(18-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Festim	Eqerem	Murati	1678	169/24	arë	497.13	207.00	102,905.91				16,361.24	119,267.15	K-34-125-(18-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Ilias	Gani	Arra	1678	173/22	arë	1,338.44	207.00	277,057.08				37,972.44	315,029.52	K-34-125-(18-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Riza	Avdyl	Sahillari	1678	173/29	arë	2,030.00	207.00	420,210.00				72,832.65	493,042.65	K-34-125-(18-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Xhevaire (dhe bashkëpronarë)	Tefik	Saliaj	3808	347/39	arë	2,170.00	162.25	352,082.50					352,082.50	K-34-113-(241-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
		Elvira	Balliu										28,521.12	28,521.12		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
6	Xhevaire		Saliaj	3808	347/40	arë							50,364.00	50,364.00	K-34-113-(241-A)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
7	Niko	Petrit	Çane	3808	347/41	arë	4,264.53	162.25	691,919.99				53,739.00	745,658.99	K-34-113-(241-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Ardian	Fahri	Salianj	3808	347/42	arë	4,495.94	162.25	729,466.27				53,952.00	783,418.27	K-34-113-(241-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Afrim	Fahri	Saliaj	3808	347/43	arë	3,253.82	162.25	527,932.30				50,437.00	578,369.30	K-34-113-(241-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Xhevit	Ismail	Buzi	2636	36/15	arë+truall	595.86	249.00	148,369.14				7,152.00	155,521.14	K-34-112-(179-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	Iljas	Isa	Fisheku	2636	39/4	arë	9,357.05	249.00	2,329,905.45					2,329,905.45	K-34-112-ë180-A]	ZVRPP konfirmon se pasuria e inskriptuar dhe me masë sekuestro nga përmbarimi
	Halit		Osmani										326,185.02	326,185.02		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
12	Kastriot	Muhamet	Xhaferllari	1420	17/80	arë	1,671.67	69.75	116,598.98					116,598.98	CO-I-4	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Xhemal		Bregu										30,396.96	30,396.96		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
13	Rrapo	Shasho	Braho	3037	7/33	arë	2,000.02	52.50	105,001.05					105,001.05	K-34-125-(139-B)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Petrit		Braho										24,000.00	24,000.00		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
14	Muharrem	Nuke	Shahini	3037	7/31	arë	1,288.54	52.50	67,648.35				15,468.00	83,116.35	K-34-125-(139-B)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	Xhevahir	Teki	Babaliu	3756	323/19	arë	1,838.00	69.75	128,200.50				22,080.00	150,280.50	K-34-125-(118-B)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
16	Hamit	Kamber	Babaliu	3756	323/22	arë	1,071.06	69.75	74,706.44					74,706.44	K-34-125-(118-B)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Ardit		Babaliu										11,510.00	11,510.00		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
17	Hasan	Ramo	Babaliu	3756	323/24	arë	1,242.76	69.75	86,682.51				14,916.00	101,598.51	K-34-125-(118-B)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
18	Lumturi	Përparim	Babaliu	3756	323/29	arë	1,069.49	69.75	74,596.93					74,596.93	K-34-125-(118-B)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Syrja		Babaliu										12,828.00	12,828.00		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat



19	Syrjat	Murat	Babaliu	3756	323/31	arë	1,036.03	69.75	72,263.09				67,081.00	139,344.09	K-34-125-(118-B)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
20	Flamur	Sami	Kapllani	3756	323/33	arë	1,884.78	69.75	131,463.41				34,269.30	165,732.71	K-34-125-(118-B)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
21	Gjyrgji	Ali	Malo	3756	323/38	arë	2,233.22	69.75	155,767.10					155,767.10	K-34-125-(118-B)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Zenepe	Bektash	Malo													
	Gazmor	Bektash	Malo													
22	Agron	Asllan	Laçi	3596	250/10	arë	4,793.94	69.75	334,377.32				104,748.90	439,126.22	K-34-125-(101-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
23	Ferat	Iljas	Alushi	3596	250/12	arë	5250	69.75	366,187.50					366,187.50	K-34-125-(101-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
	Shkelqim		Alushi										1,092,660.01	1,092,660.01		
24	Vrenos	Ali	Bega	3596	250/7	arë	4,348.50	69.75	303,307.88				52,188.00	355,495.88	K-34-125-(101-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
25	Neshat	Sulo	Bega	3596	250/9	arë	4,738.19	69.75	330,488.75				56,858.52	387,347.27	K-34-125-(101-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
26	Myhybe	Hyzeir	Qose	3528	12/11	arë	1,985.93	113.00	224,410.09					224,410.09	K-34-126-14-D	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
27	Raif	Ibrahim	Rodhani	3528	12/10	arë	2,512.27	113.00	283,886.51				30,144.00	314,030.51	K-34-126-14-D	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
28	Reis	Ramadan	Rodhani	3528	12/9	arë	2,501.80	113.00	282,703.40					282,703.40	K-34-126-14-D	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
	Dafina		Arapi										30,024.00	30,024.00		
28	Ydri	Shyqyri	Bylykbashi	3528	7/6	arë	2,592.73	161.50	418,725.90				88,213.86	506,939.76	K-34-126-15-C	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
30	Zalo	Mustafa	Agolli	3528	7/15	arë	1,765.27	161.50	285,091.11					285,091.11	K-34-126-15-C	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
	Tezbi		Agolli										13,963.86	13,963.86		
31	Almir	Asim	Agolli	3528	7/14	arë	2,334.77	161.50	377,065.36					377,065.36	K-34-126-15-C	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
	Tezbi		Agolli										12,609.00	12,609.00		
32	Hasan	Muhamer	Bylykbashi	3528	12/16	arë	1,336.42	113.00	151,015.46					151,015.46	K-34-126-14-D	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
33	Arzen		Qose	3528	7/5	arë							39,135.00	39,135.00	K-34-126-15-C	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
34	Irfan	Ramadan	Jaholli	3528	7/4	arë	3,334.32	161.50	538,492.68				50,010.00	588,502.68	K-34-126-15-C	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
35	Irfan	Ramadan	Jaholli	3528	12/22	arë	2,555.22	113.00	288,739.86				71,540.00	360,279.86	K-34-126-14-D	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
36	Arzen		Qose	3528	12/21	arë							28,000.00	28,000.00	K-34-126-14-D	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
37	Almir	Asim	Agolli	3528	12/20	arë	1,052.25	113.00	118,904.25					118,904.25	K-34-126-14-D	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
38	Zalo	Mustafa	Agolli	3528	12/19	arë	1,327.95	113.00	150,058.35					150,058.35	K-34-126-14-D	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
	Tezbi		Agolli										15,936.00	15,936.00		
39	Selajdin	Sulejman	Berberi	3528	7/7	arë	1,435.31	161.50	231,802.57					231,802.57	K-34-126-15-C	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
40	Hasan	Muhamet	Bylykbashi	3528	7/12	arë	1,125.00	161.50	181,687.50					181,687.50	K-34-126-15-C	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
41	Selajdin	Sulejman	Berberi	3528	12/24	arë	2,660.00	113.00	300,580.00					300,580.00	K-34-126-14-D	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
42	Kristo Kujtim Sanije	Muharem	Mersini Mersini Mersini	3071	117/12	arë	1,981.00	126.25	250,101.25					250,101.25	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
43	Sofia	Gaqo	Stefa	3668	282/217	arë	1,077.00	126.25	135,971.25					135,971.25	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
	Bujar		Demçe										31,646.58	31,646.58		
44	Pano	Ziko	Poçi	3668	282/40	arë	1,784.93	161.50	288,266.79				60,723.32	348,990.11	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
45	Spiro	Theodhori	Fuqi	3668	282/41	arë	1,661.58	161.50	268,345.17					268,345.17	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Përdoruesi likuidohet
	Bujar		Demçe										56,528.09	56,528.09		



																vetëm për kulturat
46	Thodhor	Thanas	Bello	3668	282/213	arë	527.69	126.25	66,620.86					66,620.86	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
47	Mihal	Petro	Taba	3668	282/21	arë	812.28	126.25	102,550.35					102,550.35	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
48	Çomo	Ziko	Poçi	3668	282/28	arë	1,605.34	126.25	202,674.18					202,674.18	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Bujar		Demçe								44,940.00	44,940.00	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat			
49	Vasil		Poçi	3668	282/19	arë	581.03	126.25	73,355.04					73,355.04	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
50	Thanas		Fuqi	3668	282/42	arë	920.07	161.50	148,591.31					148,591.31	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Bujar		Demçe									31,302.14	31,302.14	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat		
51	Jaras		Stefa	3668	282/9	arë	916.34	126.25	115,687.63					115,687.63	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
52	Thoma	Arqile	Poçi	3668	282/4	arë	1,259.65	126.25	159,030.81					159,030.81	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
53	Petro		Taba	3668	282/5	arë	1,123.68	126.25	141,864.36				22,473.40	164,337.76	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
54	Nikolla		Tanushi	3668	282/6	arë	941.38	126.25	118,848.83					118,848.83	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Leonidha		Hasankolli									18,827.40	18,827.40	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat		
55	Nikolla		Stefa	3668	282/8	arë	617.84	126.25	78,002.82					78,002.82	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
56	Kosta		Binjaku	3668	282/13	arë	934.54	161.50	150,928.21				26,180.00	177,108.21	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
57	Ilia		Binjaku	3668	282/14	arë	1,088.63	126.25	137,439.54					137,439.54	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
58	Thodhoraq		Poçi	3668	282/16	arë	981.65	126.25	123,933.31					123,933.31	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
59	Thodhoraq	Pilo	Tamushi	3668	282/197	arë	850.81	126.25	107,414.76				17,016.20	124,430.96	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
60	Sotir Jorgulla Kristina	Nikolla	Poci Mejdi (Poci) Nikollara (Poci)	3668	282/17	arë	589.00	126.25	74,361.25					74,361.25	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
61	Thoma	Miho	Bello	3668	282/3	arë	1,020.16	126.25	128,795.20					128,795.20	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
62	Vasil	Postol	Bello	3668	282/44	arë	903.37	161.50	145,894.26				29,289.20	175,183.46	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
63	Thoma	Miho	Bello	3668	282/37	arë	1,525.05	126.25	192,537.56					192,537.56	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
64	Lefter	Postol	Bello	3668	282/45	arë	793.71	161.50	128,184.17				25,735.00	153,919.16	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
65	Dhimitraq	Harito	Xega	3668	282/46	arë	514.65	161.50	83,115.98				5,661.48	88,777.46	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
66	Ziso		Ditro	3668	282/23	arë	1,021.00	161.50	164,891.50				34,748.03	199,639.53	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
67	Gaqo		Demiri	3668	282/25	arë	1,188.75	161.50	191,983.13				14,265.12	206,248.25	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
68	Kristo		Kola	3668	282/32	arë	1,422.00	161.50	229,653.00				17,064.12	246,717.12	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



69	Mihal		Kola	3668	282/33	arë	1,226.78	161.50	198,124.97				14,721.36	212,846.33	K-34-126-(103-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
70	Ndina		Kola	3668	282/34	arë	1,381.99	126.25	174,476.68				16,583.92	191,060.60	K-34-126-(103-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
71	Lifter	Andrea	Stefa	3668	7/5	arë	3,162.26	126.25	399,235.33					399,235.33	K-34-126-(103-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja “Kontratë huaje në favor të fondacionit Besa”
72	Thanas		Fuqi	3668	7/4	arë	4,773.41	126.25	602,643.01					602,643.01	K-34-126-(103-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
73	Arqile		Stefa	3668	7/2	arë	3,427.62	101.25	347,046.53				41,131.44	388,177.97	K-34-126-(103-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
74	Pilo	Nikolla	Zguri	3668	7/3	arë	5,328.25	126.25	672,691.56				63,938.40	736,629.96	K-34-126-(103-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
75	Thodhor	Thanas	Bello	3668	7/1	arë	3,155.89	126.25	398,431.11					398,431.11	K-34-126-(103-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
76	Ndrek	Pali	Vasiu	3300	1/11	arë				1,255.00	469.00	588,595.00	15,059.16	603,654.16	K-34-111-(159-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë
77	Zarik	Pilo	Mone	3300	1/17	arë				2,203.00	469.00	1,033,207.00	22,033.00	1,055,240.00	K-34-111-(159-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë
78	Lili	Gori	Koti	3300	3/27	arë				2,400.00	469.00	1,125,600.00	28,800.00	1,154,400.00	K-34-111-(159-D)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë
79	Enton	Sotir	Peto	3300	3/40	arë				2,000.00	469.00	938,000.00	24,000.24	962,000.24	K-34-111-(159-D)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë
80	Thoma	Liu	Kolici	3300	3/48	arë				2,000.00	469.00	938,000.00	24,001.20	962,001.20	K-34-111-(159-D)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë
81	Vangjel	Pali	Vasiu	3300	1/9	arë				315.00	469.00	147,735.00		147,735.00	K-34-111-(159-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë
82	Miti	Rrapi	Mone	3300	5/24	arë				2,000.00	469.00	938,000.00	24,000.84	962,000.84	K-34-111-(156-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë dhe se AMTP është në proces konfirmimi.
83	Ladi	Lask	Peto	3300	5/30	arë				1,600.00	469.00	750,400.00	19,202.04	769,602.04	K-34-111-(159-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë
84	Peco	Vasil	Filka	3300	5/32	arë				2,400.00	469.00	1,125,600.00	28,802.16	1,154,402.16	K-34-111-159-C	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë



85	Vasillaq	Todi	Hila	3300	5/37	arë				800.00	469.00	375,200.00	9,601.32	384,801.32	K-34-111-(159-D)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë
86	Arjan	Miço	Peto	3300	5/39	arë				1,600.00	469.00	750,400.00	19,200.48	769,600.48	K-34-111-(159-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë
87	Todi	Kove	Peto	3300	5/6	arë				800.00	649.00	519,200.00	9,600.12	528,800.12	K-34-111-(159-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë
88	Arqile	Llukan	Mone	3300	1/25	arë				1,252.00	469.00	587,188.00	15,024.96	602,212.96	K-34-111-(159-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
89	Petraç	Kiti	Peto	3300	1/26	arë				1,261.00	469.00	591,409.00	15,131.28	606,540.28	K-34-111-(159-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
90	Thoma	Peti	Peto	3300	1/37	arë				1,261.00	469.00	591,409.00	15,130.92	606,539.92	K-34-111-(159-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
91	Vaso	Kozma	Naci	3300	6/23	arë				2,209.00	828.00	1,829,052.00	251,296.02	2,080,348.02	K-34-111-(159-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë
92	Lipi	Vasil	Gjeka	3300	7/11	arë				488.00	828.00	404,064.00		404,064.00	K-34-111-(159-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë
	Fena		Gjeka										55,505.12	55,505.12		Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
93	Mondi	Lami	Peto	3300	5/14	arë				800.00	469.00	375,200.00	9,600.00	384,800.00	K-34-111-(159-C)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë
94	Mihal	Themi	Profka	3300	3/45	arë				1,200.00	469.00	562,800.00	14,400.12	577,200.12	K-34-111-(159-D)	ZVRPP-ja konfirmon se për këtë pasuri nuk është lëshuar certifikata e pronësisë
95	Fitret	Zini	Cocka	3787	833/29	arë				4,259.00	778.00	3,313,502.00	93,698.00	3,407,200.00	K-34-127-(65-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Jani	Zini	Rusi													
	Avdi	Zini	Rusi													
	Marjana	Zini	Cako													
	Lindita	Zini	Subashi													
	Irma	Zini	Rezhda													
96	Nexhmi	Hasan	Pasholli	3787	1088/1	arë				980.00	778.00	762,440.00	14,703.45	777,143.45	K-34-127-(65-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
97	Xhevat	Velisha	Berberi	3787	1088/3	arë				1,620.00	778.00	1,260,360.00	24,306.00	1,284,666.00	K-34-127-(65-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
98	Vladimir	Xhemil	Lëngu	3787	832/39	arë				1,723.00	778.00	1,340,494.00	58,615.44	1,399,109.44	K-34-127-(49-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
99	Avdi	Zini	Rusi	3787	833/27	arë				1,890.00	778.00	1,470,420.00	61,265.05	1,531,685.05	K-34-126-(64-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
100	Pëllump	Selami	Rusi	3787	1088/5	arë				1,071.00	778.00	833,238.00	23,551.22	856,789.22	K-34-127-(65-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
101	Agim	Bariq	Rusi	3787	833/26	arë				2,679.00	778.00	2,084,262.00	304,087.06	2,388,349.06	K-34-126-(64-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
102	Petrit	Selami	Rusi	3787	1088/7	arë				1,950.00	778.00	1,517,100.00	29,256.60	1,546,356.60	K-34-127-(65-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
103	Fevri	Pasho	Pasholli	3787	833/25	arë				1,889.00	778.00	1,469,642.00	20,781.31	1,490,423.31	K-34-127-(64-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



104	Tomor	Skënder	Pasholli	3787	833/24	arë				1,099.00	778.00	855,022.00	24,179.76	879,201.76	K-34-127-(64-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
105	Xhezmi	Shahin	Rusi	3787	833/11	arë				2,679.00	778.00	2,084,262.00	58,934.48	2,143,196.48	K-34-126-(64-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
106	Stavro	Isuf	Topçiu	3787	824/32	arë				1,653.00	778.00	1,286,034.00	33,060.00	1,319,094.00	K-34-127-(49-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
107	Bardhi	Qamil	Bejleri	3787	834/22	arë				2,065.00	778.00	1,606,570.00	45,430.00	1,652,000.00	K-34-126-(64-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
108	Fitret	Rahmi	Çollaku	3787	825/7	arë				1,950.00	778.00	1,517,100.00	42,907.26	1,560,007.26	K-34-127-(49-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Fillareta	Rahmi	Dilka													
	Nezaqet	Rahmi	Manelli													
	Vexhi	Rahmi	Voci													
	Fevri	Rahmi	Voci													
	Bedri	Rahmi	Voci													
109	Fazlli	Zini	Mullkhi	3787	825/9	arë				1,170.00	778.00	910,260.00	25,746.60	936,006.60	K-34-127-(49-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
110	Skënder	Pasho	Pasholli	3787	833/23	arë				549.00	778.00	427,122.00		427,122.00	K-34-126-(64-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
111	Stavro	Isuf	Topçiu	3787	834/44	arë				3,844.00	778.00	2,990,632.00	741,924.81	3,732,556.81	K-34-126-(80-B)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
112	Petrit	Gurtali	Nallbati	3787	1088/13	arë				1,560.00	778.00	1,213,680.00	18,715.32	1,232,395.32	K-34-127-(65-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Sotir	Estref	Pandeli							780.00	778.00	606,840.00		606,840.00	K-34-127-(65-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
113	Petrit		Haliti	3787	1088/14	arë							17,164.18	17,164.18	K-34-127-(65-A)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
114	Julian	Bujar	Pasholli	3787	833/20	arë				1,889.00	778.00	1,469,642.00	41,554.92	1,511,196.92	K-34-126-(80-B)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
115	Petrit		Haliti	3787	1088/16	arë							25,741.98	25,741.98	K-34-127-(65-A)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
116	Sali	Sabri	Goce	3787	1088/17	arë				2,340.00	778.00	1,820,520.00		1,820,520.00	K-34-127-(65-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Fredi		Goce										35,106.00	35,106.00		
117	Namik	Selman	Goce	3787	1088/19	arë				1,560.00	778.00	1,213,680.00	43,675.52	1,257,355.52	K-34-127-(65-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
118	Simon	Abdyraman	Goce	3787	1088/20	arë				2,720.00	778.00	2,116,160.00	76,164.20	2,192,324.20	K-34-127-(65-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
119	Bardhi	Qamil	Bejleri	3787	1092/3	arë				2,100.00	778.00	1,633,800.00	46,200.00	1,680,000.00	K-34-127-(65-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
120	Gëzim	Bajram	Pasholli	3787	833/17	arë				3,469.00	778.00	2,698,882.00		2,698,882.00	K-34-126-(64-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
121	Skënder	Pasho	Pasholli	3787	834/47	arë				1,605.00	778.00	1,248,690.00	35,317.48	1,284,007.48	K-34-126-(64-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
122	Oliandi	Sheqadet	Lame	3787	833/15	arë				1,099.00	778.00	855,022.00	12,089.00	867,111.00	K-34-126-(64-D)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
123	Artur	Hytbi	Subashi	3787	1088/23	arë				2,340.00	778.00	1,820,520.00	51,490.56	1,872,010.56	K-34-127-(65-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
124	Astrit	Xhemil	Lengu	3787	1092/5	arë				1,680.00	778.00	1,307,040.00		1,307,040.00	K-34-127-(65-A)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
